REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**
**K.P.P 100/2021**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|---|---|
| Jonaid Myzyri | Kryetar |
| Enkeleda Bega | Nënkryetar |
| Vilma Zhupaj | Anëtar |
| Lindita Skeja | Anëtar |
| Merita Zeqaj | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 19.02.2021 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt**: Modifikimi i dokumentave standarte të tenderit për proçedurën e prokurimit *"Procedurë e Hapur"*, me Nr. *REF- 83794-01-11-2021*, me objekt "*Sigurimin e ageve të skleroterapisë për trajtimin e pacientëve me hemoragji digjestive dhe ageve të biopsisë për diagnozën e pacientëve me patologji të traktit tretës, si dhe materiale mjekësore për endoskopi për vitin 2020-2021"*, me fond limit *18,796,810* lekë pa tvsh dhe shumatorja e çmimeve për njësi: *4,301,650.00* leke pa tvsh, publikuar më datë 12.01.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza.

**Ankimues:** "Montal" shpk
Adresa: Rruga "Dervish Hima", 3 Kullat, K.3, Shk.1, Ap.9/2, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor** Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza.
Adresa: Rruga "Dibrës", Nr. 372, Tiranë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik"*, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik

nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *"Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*, Neni 4 Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *"Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19".*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V ë r e n:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 12.01.2021 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit *"Procedurë e Hapur",* me Nr. *REF- 83794-01-11-2021*, me objekt "*Sigurimin e ageve të skleroterapisë për trajtimin e pacientëve me hemoragji digjestive dhe ageve të biopsisë për diagnozën e pacientëve me patologji të traktit tretës, si dhe materiale mjekësore për endoskopi për vitin 2020-2021",* me fond limit *18,796,810* lekë pa tvsh dhe shumatorja e çmimeve për njësi: *4,301,650.00* leke pa tvsh, publikuar më datë 12.01.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza.

II.2. Në datën 18.01.2021, operatori ekonomik "*Montal"* shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të proçedurës së mësipërme të prokurimit me argumentat si më poshtë:

*A- Shtojca Nr.6*
*Shtojca Nr.6 e kerkuar ne DST nuk eshte ne perputhje me Vendimin Nr. 06, Date 05.10.2020 te Agjencise se Prokurimit Publik.*

*B- Shtojca Nr. 9 – Pika 2- Kriteret e Vecanta te Kualifikimit*
*Pika 2.3 Kapaciteti teknik - Kerkohet:*

*b) Per te gjithe artikujt e ofertuar me shenjen asterisko (*) tek nr, duhet te paraqiten mostra diten e hapjes se ofertave, me date __.__.2021 ne oren 10:00. Dorezimi i kampioneve/mostrave, te behet prane Drejtorise Juridike/Sektori Prokurimeve, QSUT "Nene Tereza", te mbyllura ne nje zarf /kuti jo transparente te vulosur mbi te cilin te shenohet:*

- *"Mos e hapni me përjashtim te rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit te Ofertave te procedurës se prokurimit « ……… » dhe jo para datës ___.___ .2021, ora 10:00.*
- *Se bashku me mostrat ofertuesi duhet te japë edhe një shkrese te vulosur dhe firmosur ku te listohen mostrat qe ndodhen ne zarf/kuti.*
- *Mbi çdo mostër te dorëzuar, ofertuesi duhet te shënoje Nr.Rendor te Artikullit qe përfaqëson.*

*Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë te shoqëruara me listën e inventarizimit dhe te identifikuara sipas Nr. Rendor, nëse ka mungesa mostrash për artikuj te veçante, atëherë oferta do te quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do te s'kualifikohet.*

*Deshirojme te veme ne dukje faktin qe jane kerkuar mostra specifike te artikujve me permasa te vecanta. Nderkohe qe per vleresimin e materialeve mjafton qe komisioni te kete ne dispozicion vetem nje moster te kategorise se produktit te kerkuar pavaresisht dimensionit. Kjo kerkese veshtireson artificialisht sigurimin e mostres specifike nga pikepamja dimensionale dhe kufizon mundesine e pjesernarrjes ne procedure, Evidentojme me poshte rastet specifike te kerkeses per mostra me dimensione specifike per kategorite e artikujve ne fjale.*

***Gide hidrofilike per ERCP** - Artikujt me Nr. 1-7 jane kerkuar te paraqiten dy mostra, perkatesisht artikujt Nr. 2 dhe Nr. 5. Dy artikujt e kerkuar si mostra nuk kane asgje me specifike se artikujt e tjere te kesaj kategorie. Gjithashtu, ben pershtypje fakti qe mostrat e kerkuara i perkasin artikujve me sasi 5 cope dhe per artikuj me sasi dyfish (10 cope) sic eshte artikulli Nr. l nuk eshte kerkuar moster. Kjo kerkese eshte e pakuptimte dhe favorizon vetem kompanine e cila i ka gjendje specifikisht artikujt Nr. 2 dhe Nr. 5. Rrjedhimisht kerkojme qe te paraqitet vetem nje moster Gide hidrofilike per ERCP me dimensione te perfshire ne nje nga Artikujt Nr. 1 deri ne Nr. 7 sepse prania e dimensioneve te tjera te kerkuara mund te verifikohet jo vetem me dokumentat teknike te prodhuesit por edhe nepermjet ofertes teknike qe i kerkohet te paraqese operatorit ekonomik.*

***Papapilotom*** *- Artikujt me Nr. 8-18 jane kerkuar te paraqiten dy mostra, perkatesisht artikujt Nr.9 dhe Nr.17. Dy artikujt e kerkuar si mostra nuk kane asgje me specifike se artikujt e tjere te kesaj kategorie. Rrjedhimisht kerkojme qe te paraqitet vetem nje moster Papilotom me dimensione te perfshire ne nje nga Artikujt Nr. 8 deri ne Nr. 18 sepse prania e dimensioneve te tjera te kerkuara mund te verifikohet jo vetem me dokumentat teknike te prodhuesit por edhe nepermjet ofertes teknike qe i kerkohet te paraqese operatorit ekonomik.*

***Stente biliare*** *- Artikujt me Nr. 19-25 eshte kerkuar te paraqitet moster vetem specifike per artikullin Nr. 21. Kerkesa per moster specifikisht per artikullin Nr. 21 eshte diskriminuese sepse favorizon vetem operatorin ekonomik i cili e ka gjendje ate stente me madhesi specifike. Artikulli i kerkuar si moster nuk ka asgje me specifike se artikujt e tjere te kesaj kategorie. Rrjedhimisht kerkojme qe te paraqitet vetem nje moster Stente biliare me dimensione te perfshire ne nje nga Artikujt Nr. 19 deri ne Nr. 25 sepse prania e dimensioneve te tjera te kerkuara mund te verifikohet jo vetem me dokumentat teknike te prodhuesit por edhe nepermjet ofertes teknike qe i kerkohet te paraqese operatorit ekonomik.*

***Introducer*** *- Artikujt me Nr. 26-28 eshte kerkuar te paraqitet moster specifike per artikullin Nr. 27. Kerkesa per moster specifikisht per artikullin Nr. 27 eshte diskriminuese sepse favorizon vetem operatorin ekonomik i cili e ka gjendje ate introduktor me madhesi specifike. Artikulli i kerkuar si moster nuk ka asgje me specifike se artikujt e tjere te kesaj kategorie. Rrjedhimisht kerkojme qe te paraqitet vetem nje moster Introduktor me dimensione te perfshire ne nje nga Artikujt Nr. 26 deri ne Nr. 28 sepse prania e dimensioneve te tjera te kerkuara mund te verifikohet jo vetem me dokumentat teknike te prodhuesit por edhe nepermjet ofertes teknike qe i kerkohet te paraqese operatorit ekonomik.*

***Shporte per thyerje dhe terheqje guresh biliare*** *- Artikujt me Nr. 38-41 eshte kerkuar te paraqitet moster specifike per artikullin Nr. 39. Kerkesa per moster specifikisht per artikullin Nr. 39 eshte diskriminuese sepse favorizon vetem operatorin ekonomik i cili e ka gjendje ate shporte me madhesi specifike. Artikulli i kerkuar si moster nuk ka asgje me specifike se artikujt e tjere te kesaj kategorie. Rrjedhimisht kerkojme qe te paraqitet vetem nje moster Shporte per thyerje dhe terheqje guresh biliare me dimensione te perfshire ne nje nga Artikujt Nr. 38 deri ne Nr. 41 sepse prania e dimensioneve te tjera te kerkuara mund te verifikohet jo vetem me dokumentat teknike te prodhuesit por edhe nepermjet ofertes teknike qe i kerkohet te paraqese operatorit ekonomik.*

***Rrjeta per terheqje guresh*** *- Artikujt me Nr. 42 - 46 eshte kerkuar te paraqitet moster specifike per artikullin Nr. 44. Autoriteti Kontraktor kerkon specifikisht vetem moster per artikullin Nr. 44 nderkohe qe te gjithe artikujt e kesaj kategorie produktesh kane te njejtat karakteristika funksionale dhe ndryshojne vetem madhesite. Kerkesa per master specifike per artikullin Nr. 44 eshte diskriminuese sepse favorizon vetem operatorin ekonomik i cili e ka gjendje ate shporte me madhesi specifike. Rrjedhimisht kerkojme qe te paraqitet vetem nje moster Rrjeta per terheqje guresh me dimensione te perfshire ne nje nga Artikujt Nr. 42 deri ne Nr. 46 sepse prania e dimensioneve te tjera te kerkuara mund te verifikohet jo vetem me dokumentat teknike te prodhuesit por edhe nepermjet ofertes teknike qe i kerkohet te paraqese operatorit ekonomik.*

***Ballona Ekstraktimi Biliare*** *- Artikujt me Nr. 47 - 52 jane kerkuar te paraqiten dy mostra, perkatesisht artikujt Nr. 48 dhe Nr. 51. Dy artikujt e kerkuar si mostra nuk kane asgje me specifike se artikujt e tjere te kesaj kategorie pervec; madhesive. Kerkesa per mostra specifike per artikujt Nr. 48 dhe Nr. 51 eshte diskriminuese sepse favorizon vetem operatorin ekonomik i cili i ka gjendje ato dy mostra me madhesi specifike. Rrjedhimisht kerkojme qe te paraqitet vetem nje master Ballona Ekstraktimi Biliare me dimensione te perfshire ne nje nga Artikujt Nr. 47 deri ne Nr. 52 sepse prania e dimensioneve te tjera te kerkuara mund te verifikohet jo vetem me dokumentat teknike te prodhuesit por edhe nepermjet ofertes teknike qe i kerkohet te paraqese operatorit ekonomik.*

***Ballon dilatacioni me multi stage*** *- Artikujt me Nr. 55 - 60 eshte kerkuar te paraqitet moster specifike per artikullin Nr. 58. Eshte e pakuptueshme pse Autoriteti Kontraktor kerkon specifikisht vetem moster per artikullin Nr. 58 nderkohe qe te gjithe artikujt e kesaj kategorie produktesh kane te njejtat karakteristika funksionale dhe ndryshojne vetem madhesite. Kerkesa per moster specifike per artikullin Nr. 58 eshte diskriminuese sepse favorizon vetem operatorin ekonomik i cili e ka gjendje ate Ballon me madhesi specifike. Rrjedhimisht. kerkojme qe te paraqitet vetem nje moster Ballon dilatacioni me multi stage me dimensione te perfshire ne nje nga Artikujt Nr. 55 deri ne Nr. 60 sepse prania e dimensioneve te tjera te kerkuara mund te verifikohet jo vetem me dokumentat teknike te prodhuesit por edhe nepermjet ofertes teknike qe i kerkohet te paraqese operatorit ekonomik.*

***Pistolete fryrese*** *- Artikulli Nr. 61 eshte kerkuar te paraqitet moster nderkohe qe sasia e kerkuar eshte vetem 3 cope. Evidentojme faktin qe ky produkt ka kosto te larte dhe sasia e kerkuar ne kete procedure nuk e justifikon kerkesen per nje moster. Gjithashtu, karakteristikat teknike dhe funksionale te pajisjes mund te verifikohen fare mire nepermjet dokuementave teknike te prodhuesit pa pasur nevoje per moster. Rrjedhimisht kerkojme qe te hiqet kerkesa per moster per kete artikull.*

***Klipe hemostatike gastrointestinale*** *- Artikujt me Nr. 62 - 67 eshte kerkuar te paraqitet moster specifike per artikullin Nr. 64 i cili ka te njejtat karakteristika funksionale me artikujt e tjere Nr. 62 deri ne Nr. 67. Eshte e pakuptueshme pse Autoriteti Kontraktor kerkon specifikisht vetem moster per artikullin Nr. 64. Kerkesa per moster specifike per artikullin Nr. 64 eshte diskriminuese sepse favorizon vetem operatorin ekonomik i cili e ka gjendje ate Klip hemostatik me madhesi specifike. Rrjedhimisht kerkojme qe te paraqitet vetem nje moster Klipe hemostatike gastrointestinale me dimensione te perfshire ne nje nga Artikujt Nr. 62 deri ne Nr. 67 sepse prania e dimensioneve te tjera te kerkuara mund te verifikohet jo vetem me dokumentat teknike te prodhuesit por edhe nepermjet ofertes teknike qe i kerkohet te paraqese operatorit ekonomik.*

***Ligature varicesh ezofagal*** *- Artikujt me Nr. 68 - 69 eshte kerkuar te paraqitet moster specifike per artikullin Nr. 69 nderkohe qe edhe artikulli Nr. 68 ka te njejtat karakteristika funksionale pervec dimensioneve. Kerkesa per moster specifike per artikullin Nr. 69 eshte diskriminuese sepse favorizon vetem operatorin ekonomik i cili e ka gjendje ate Ligature varicesh ezofageale me madhesi specifike. Rrjedhimisht kerkojme qe te paraqitet vetem nje moster Ligature varicesh ezofagal me dimensione te perfshire ne nje nga Artikuit Nr. 68 ose*

*Nr. 69 sepse prania e dimensioneve te tjera te kerkuara mund te verifikohet jo vetem me dokumentat teknike te prodhuesit por edhe nepermjet ofertes teknike qe i kerkohet te paraqese operatorit ekonamik.*

***Age skleroterapie** - Artikujt me Nr. 70 - 77 jane kerkuar te paraqiten dy mostra, perkatesisht artikujt Nr. 70 dhe Nr. 75. Dy artikujt e kerkuar si mostra nuk kane asgje me specifike se artikujt e tjere te kesaj kategorie pervec madhesive. Kerkesa per mostra specifike per artikujt Nr. 70 dhe Nr. 75 eshte diskriminuese sepse favorizon vetem operatorin ekonomik i cili i ka gjendje ato dy mostra me madhesi specifike. Rrjedhimisht kerkojme qe te paraqitet vetem nje moster Age skleroterapie me dimensione te perfshire ne nje nga Artikujt Nr. 70 deri ne Nr. 77 sepse prania e dimensioneve te tjera te kerkuara mund te verifikohet jo vetem me dokumentat teknike te prodhuesit por edhe nepermjet ofertes teknike qe i kerkohet te paraqese operatorit ekonomik.*

***Forceps biopsie** = Artikujt me Nr. 80 - 83 jane kerkuar te paraqiten mostra per te gjithe keto artikuj. Evidentojme faktin qe te katert artikuj Nr. 80 - 83 kane karakteristika funksionale te njejta dhe ndryshon vetem gjatesia e tyre. Kerkesa per mostra specifike per te gjithe artikujt Nr. 80 - 83 eshte diskriminuese sepse favorizon vetem operatorin ekonomik i cili i ka gjendje ato kater mostra me madhesi specifike. Rrjedhimisht kerkojme qe te paraqitet vetem nje moster Forceps biopsie me dimensione ose karakteristika te perfshira ne nje nga Artikujt Nr. 80 deri ne Nr. 83 sepse prania e dimensioneve dhe karakteristikave te tjera te kerkuara mund te verifikohet jo vetem me dokumentat teknike te prodhuesit por edhe nepermjet ofertes teknike qe i kerkohet te paraqese operatorit ekonomik.*

***Ngjites per varicet ezofageale dhe fundale** - Artikulli Nr. 85 eshte kerkuar te paraqitet moster nderkohe qe sasia e kerkuar eshte vetem 10 cope. Evidentojme faktin qe karakteristikat e ketij produkti nuk mund te verifikohen nepermjet mostres por nepermjet dokumentave teknike te prodhuesit pa pasur nevoje per moster. Mostra eshte vetem nje tubete dhe kerkesa per paraqitjen e saj vetem sa veshtireson dhe dekurajon pjesemarrjen e operatoreve ekonomike te cilet nuk e kane gjendje kete produkt. Rrjedhimisht kerkojme qe te hiqet kerkesa per moster per kete artikull.*

*Cdo kerkese per me shume se nje moster per nje kategori produkti do te ishte nje abuzim me percaktimin e Ligjit te Prokurimit Publik, Neni 23 dhe shkelje e parimeve baze te Ligjit te Prokurimit Publik, neni 1, Pika 2, ku percaktohet:*

*2. Qellimi i ketij ligji eshte:*

*a) te rrise eficencen dhe efikasitetin ne procedural e prokurimit publik, te kryera nga autoritetet kontraktore;*

*b) te siguroje mireperdorim te fondeve publike dhe te ule shpenzimet procedurale;*

*c) te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit publik;*

*9) te nxise konkurrencen ndermjet operatoreve ekonomike;*

*d) te siguroje nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithe operatoret ekonomike, pjesemarres ne procedurat e prokurimit publik;*

*dh) te siguroje integritet, besim publik dhe transparence ne procedurat e prokurimit publik.*

*Kerkesa e pajustifikuar e me shume se nje mostre per nje kategori produkti dhe kerkesa per mostra te artikujve me sasi te vogel ul efikasitetin e procedures se prokurimit, rrit shpenzimet proceduriale, dekurajon pjesemarrjen e operatoreve ekonomike, ul konkurrencen, dhe te gjitha keto perbejne trajtim te pabarabarte dhe diskriminues te operatoreve ekonomike te interesuar per te marre pjese ne gare.*

*C – Shtojca Nr. 10 Specifikikimet Teknike*

*C1 –Produkete me specifikime te mbyllura te prodhuesit Kinez Micro – Tech (Nanjing) Co Ltd. Veme re se pjesa me e madhe e specifikimeve jane pergatitur ekskluzivisht ne forme "copy-paste" per produktet e prodhuesit kinez MICRO-TECH (Nanjing) Co., Ltd. (shih kodet e produkteve te paracaktuara ne Shtojcen A dhe kataloget perkates).*

*Keto specifikime e bejne kete procedure nje gare te mbyllur paraprakisht duke perjashtuar konkurrimin e produkteve te tjera sic jane produktet e prodhuesit prestigjoz Amerikan Boston Scientific dhe prodhuesit prestigjoz Gjerman KARL-STORZ, kompani te rnirenjohura nderkombetarisht te cilat perfaqesohen nga kompania "MONTAL" sh.p.k. ne Shqiperi. Lidhur me perkatesine e specifikimeve teknike te DST me produktet eshte nje fakt i paprecedente qe per procedura me rrezik te larte vdekshmerie sic eshte ERCP (Endoscopic retrograde cholangiopancreatograpby) te perdoren specifikime reference nga firma te dores se dyte/trete, te perpiluara ekskluzivisht per te perjashtuar produkte prestigjoze te kompanive lider Boterore.*

*Ne gjykimin tone, kjo menyre nuk i pershtatet reputacionit dhe cilesise se sherbimit te qendres spitalore universitare me te madhe ne vend. Gjithashtu, nga pikepamja ligjore, sic do te deshmohet ne vijim e gjithe kjo procedure bie ne kundershtim me parimet baze te Ligjit te Prokurimit Publik, te cilat jane:*

*LPP- Neni 1, Pika 2*

*a) te rrise eficencen dhe efikasitetin ne procedurat e prokurimit publik, te kryera nga autoritetet kontraktore;*

*b) te siguroje mireperdorim te fondeve publike dhe te ulte shpenzimet procedurale;*

*c) te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit publik;*

*c) te nxise konkurrencen ndermjet operatoreve ekonomike;*

*d) te siguroje nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithe operatoret ekonomike, pjesemarres ne procedurat e prokurimit publik;*

*dh) te siguroje integritet, besim publik dhe transparence ne procedurat e prokurimit publik*

*Me konkretisht, ju lutemi te gjeni bashkengjitur Shtojcen - A me te gjithe specifikimet unike te cilat e bejne kete gare te pervetshme dhe me propozimet tona per te kryer ndryshimet e nevojshme per te hapur garen.*

*C – 2 Produkte Unike te prodhuesit AMG International, kompani ne pronesi te Q3 Medical Devices. Artikujt Nr. 29 - 37 - Stente Biliare/Pankreatike e biodegradueshme jane produkte unike boterore te prodhuesit AMG International i cili eshte pjese e kompanise Q3 Medical Devices.*

*Bashkengjitur gjendet broshura e produktit "ARCHIMEDES" ku evidentohet qarte perkatesia me specifikimet unike te artikujve Nr. 29 - 37.*

*Fakti qe stenta "ARCHIMEDES" eshte unike ne bote mund te vertetohet nepermjet adresave ëeb te listuara meposhte materialet e te cilave i gjeni bashkengjitur ne listen e shtojcave.*

- *http://ëëë.q3medical.com/neës/ARCHIMEDES_CE_Mark_approval.pdf*
- *http://ëëë.nsmedicaldevices.com/neës/amg-announces-first-placement-of-archimedes-biodegradable-biliary-and-pancreatic-stent-in-hong-kong/*

*Gjirhashtu, kompania Q3 Medical Devices ka nenshkruar nje marreveshje bashkepunimi nepermjet te ciles autorizon kompanine "MEDTRONIC" te tregtoje stenten unike te biodegradueshme model ARCHIMEDES. Me poshte mund te gjeni adresen ëeb te rnarreveshjes se bashkepunimit te listuar edhe ne listen e shtojcave.*

- *http://ëëë.amggastro.com/neës/Medtronic_Agreement_PR.pdf*

*Sic u deshmua mesiper, artikujt Nr. 29 - 37, jane produkte unike ne bote dhe rrjedhimisht e bejne kete procedure prokurimi totalisht te mbyllur ne vetem nje operator ekonomik. Per kete arsye kerkojme qe keto produkte te hiqen nga kjo procedure prokurimi dhe te prokurohen vecmas, pa cenuar konkurencen e procedures aktuale.*

*Per me teper, nga informacioni publik i Agjencise se Barnave dhe Pajisjeve Mjekesore mund te vertetohet se operatore ekonomik i cili ka kryer regjistrimin e produkteve MICRO-TECH (Nanjing) Co.Ltd ne vitin 2020 eshte e njejta kompani e cila perfaqeson edhe prodhuesin MEDTRONIC ne Shqiperi.*

*Te gjithe faktet mesiper e bejne kete procedure prokurimi krejtesisht te mbyllur ne vetem nje operator ekonornik duke cenuar legjitimitetin e pjesemarrjes se gjithe operatoreve te tjere ekonomike.*

*Ne konkluzion kerkojme qe ky tender te anullohet.*

*Tenderi i ri duhet te ndahet ne te pakten dy lote, njeri prej loteve te perfshije te gjithe artikujt e kerkuar ne tender pervec artikujve ekskluzive te kompanise AMG (Art. 29 - 37) dhe Artikullin Nr. 91 te cilet duhet te ndahen ne lot/lote te vecante.*

*Kerkojme gjithashtu, qe per tenderin i cili duhet te rishpallet te merren parasysh te gjithe kerkesat e parashtruara nga ne ne lidhje me specifikimet teknike (Shih Shtojcen A) dhe ne lidhje me rnostrat (shih piken B re kesaj ankese).*

*Ju falenderojme per bashkepunimin dhe besojme ne vleresimin tuaj objektiv te argumentave tone.*

II.2.1. Në datë 04.02.2021 me shkresën nr 334/5 prot, pala ankimuese operatori ekonomik "*Montal"* shpk ka marrë dijeni në lidhje me mospranimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor:

II.2.2. Në datën 28.01.2021 operatori ekonomik "*Montal*" sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e ngritur pranë autoritetit kontraktor.

II.3. Me shkresën nr. 334/7 prot, datë 08.02.2021, protokolluar me tonën me nr. 155/2 prot, datë 11.02.2021 si dhe me shkresën nr. 334/8 prot, datë 09.02.2021, protokolluar me tonën me nr. 155/3 prot, datë 11.02.2021, me objekt "*Informacion*" është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

## III
## Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*Montal"* sh.p.k. për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit, sipas argumentimit si më poshtë vijon: "*Shtojca Nr.6 e kerkuar ne DST nuk eshte ne perputhje me Vendimin Nr. 06, Date 05.10.2020 te Agjencise se Prokurimit Publik.",* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në dokumentat e tenderit te publikuara në SPE në shtojcën 6 "Specifikimet teknike", nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar:

**Shtojca 6**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

***DEKLARATË MBI PERMBUSHJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE***

*Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik, që do të zhvillohet në datë _________________ nga Autoriteti Kontraktor________________ me objekt ____________ me fond limit __________.*

*Unë i nënshkruari _______________,me cilësinë e ________ të personit juridik _______________deklaroj se:*

*Përmbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me çertifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë.*

*Data e dorëzimit të deklaratës ________________*
*Përfaqësuesi i ofertuesit*
*Nënshkrimi*
*Vula*

III.1.2. Në shtojcën e modifikuar të publikuar në SPE nga ana e autoritetit kontraktor shtojca 6 "*Specifikimet teknike*", është përcaktuar:

*Bëhën ndryshime në DST, konkretisht shtojca nr.6 (Deklaratë mbi Përmbushjen e Specifikimeve Teknike nga Operatori Ekonomik), si më poshtë:*

**ISHTE:**

**Shtojca 6**

*[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]*

***DEKLARATË MBI PERMBUSHJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE***

*Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik, që do të zhvillohet në datë _________________ nga Autoriteti Kontraktor________________ me objekt ____________ me fond limit __________.*

*Unë i nënshkruari _______________,me cilësinë e ________ të personit juridik _______________deklaroj se:*

*Përmbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me çertifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë.*

*Data e dorëzimit të deklaratës ________________*
*Përfaqësuesi i ofertuesit*
*Nënshkrimi*
*Vula*

**<u>BËHET</u>:**

***Shtojca 6***

*[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]*

***DEKLARATË MBI PERMBUSHJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE REALIZIMIN E OBJEKTIT SIPAS GRAFIKUT TË LËVRIMIT***

*Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik, që do të zhvillohet në datë _________________ nga Autoriteti Kontraktor________________ me objekt ____________ me fond limit __________.*

*Unë i nënshkruari _______________,me cilësinë e ________ të personit juridik _______________deklaroj se:*

*Përmbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me çertifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë si dhe marrim përsipër realizimin e objektit sipas grafikut të lëvrimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor.*

*Data e dorëzimit të deklaratës ________________*
*Përfaqësuesi i ofertuesit*
*Nënshkrimi*
*Vula*

III.1.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Montal" sh.p.k se shtojca nr. 6 e publikuar nuk është në përputhje me vendimin e APP, rezulton se autoriteti kontraktor e ka pranuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues duke bërë modifikimin e dokumentave standarte të tenderit konkretisht shtojcën nr. 6, sipas përcaktimeve të Vendimit Nr. 06, datë 5.10.2020, "*Për miratimin e disa ndryshimeve në dokumentat standarte të tenderit për mallra, punë, shërbime*" të APP, dhe duke e publikuar atë në SPE, ndaj në këto kushte pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk do të merren në shqyrtim.

Përsa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues për këtë pikë nuk do të merret në shqyrtim.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*Montal*" sh.p.k. për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit, sipas argumentimit si më poshtë vijon: "*Deshirojme te veme ne dukje faktin qe jane kerkuar mostra specifike te artikujve me permasa te vecanta. Nderkohe qe per vleresimin e materialeve mjafton qe komisioni te kete ne dispozicion vetem nje moster te kategorise se produktit te kerkuar pavaresisht dimensionit. Kjo kerkese veshtireson artificialisht sigurimin e mostres specifike nga pikepamja dimensionale dhe kufizon mundesine e pjesernarrjes ne procedure, Evidentojme me poshte rastet specifike te kerkeses per mostra me dimensione specifike per kategorite e artikujve ne*

*fjale.* ***Gide hidrofilike per ERCP*** *- Artikujt me Nr. 1-7 jane kerkuar te paraqiten dy mostra, perkatesisht artikujt Nr. 2 dhe Nr. 5. Dy artikujt e kerkuar si mostra nuk kane asgje me specifike se artikujt e tjere te kesaj kategorie. Gjithashtu, ben pershtypje fakti qe mostrat e kerkuara i perkasin artikujve me sasi 5 cope dhe per artikuj me sasi dyfish (10 cope) sic eshte artikulli Nr. l nuk eshte kerkuar moster. Kjo kerkese eshte e pakuptimte dhe favorizon vetem kompanine e cila i ka gjendje specifikisht artikujt Nr. 2 dhe Nr. 5. Rrjedhimisht kerkojme qe te paraqitet vetem nje moster Gide hidrofilike per ERCP me dimensione te perfshire ne nje nga Artikujt Nr. 1 deri ne Nr. 7 sepse prania e dimensioneve te tjera te kerkuara mund te verifikohet jo vetem me dokumentat teknike te prodhuesit por edhe nepermjet ofertes teknike qe i kerkohet te paraqese operatorit ekonomik.* ***Papapilotom*** *- Artikujt me Nr. 8-18 jane kerkuar te paraqiten dy mostra, perkatesisht artikujt Nr.9 dhe Nr.17. Dy artikujt e kerkuar si mostra nuk kane asgje me specifike se artikujt e tjere te kesaj kategorie. Rrjedhimisht kerkojme qe te paraqitet vetem nje moster Papilotom me dimensione te perfshire ne nje nga Artikujt Nr. 8 deri ne Nr. 18 sepse prania e dimensioneve te tjera te kerkuara mund te verifikohet jo vetem me dokumentat teknike te prodhuesit por edhe nepermjet ofertes teknike qe i kerkohet te paraqese operatorit ekonomik.* ***Stente biliare*** *- Artikujt me Nr. 19-25 eshte kerkuar te paraqitet moster vetem specifike per artikullin Nr. 21. Kerkesa per moster specifikisht per artikullin Nr. 21 eshte diskriminuese sepse favorizon vetem operatorin ekonomik i cili e ka gjendje ate stente me madhesi specifike. Artikulli i kerkuar si moster nuk ka asgje me specifike se artikujt e tjere te kesaj kategorie. Rrjedhimisht kerkojme qe te paraqitet vetem nje moster Stente biliare me dimensione te perfshire ne nje nga Artikujt Nr. 19 deri ne Nr. 25 sepse prania e dimensioneve te tjera te kerkuara mund te verifikohet jo vetem me dokumentat teknike te prodhuesit por edhe nepermjet ofertes teknike qe i kerkohet te paraqese operatorit ekonomik.* ***Introducer*** *- Artikujt me Nr. 26-28 eshte kerkuar te paraqitet moster specifike per artikullin Nr. 27. Kerkesa per moster specifikisht per artikullin Nr. 27 eshte diskriminuese sepse favorizon vetem operatorin ekonomik i cili e ka gjendje ate introduktor me madhesi specifike. Artikulli i kerkuar si moster nuk ka asgje me specifike se artikujt e tjere te kesaj kategorie. Rrjedhimisht kerkojme qe te paraqitet vetem nje moster Introduktor me dimensione te perfshire ne nje nga Artikujt Nr. 26 deri ne Nr. 28 sepse prania e dimensioneve te tjera te kerkuara mund te verifikohet jo vetem me dokumentat teknike te prodhuesit por edhe nepermjet ofertes teknike qe i kerkohet te paraqese operatorit ekonomik.* ***Shporte per thyerje dhe terheqje guresh biliare*** *- Artikujt me Nr. 38-41 eshte kerkuar te paraqitet moster specifike per artikullin Nr. 39. Kerkesa per moster specifikisht per artikullin Nr. 39 eshte diskriminuese sepse favorizon vetem operatorin ekonomik i cili e ka gjendje ate shporte me madhesi specifike. Artikulli i kerkuar si moster nuk ka asgje me specifike se artikujt e tjere te kesaj kategorie. Rrjedhimisht kerkojme qe te paraqitet vetem nje moster Shporte per thyerje dhe terheqje guresh biliare me dimensione te perfshire ne nje nga Artikujt Nr. 38 deri ne Nr. 41 sepse prania e dimensioneve te tjera te kerkuara mund te verifikohet jo vetem me dokumentat teknike te prodhuesit por edhe nepermjet ofertes teknike qe i kerkohet te paraqese operatorit ekonomik.* ***Rrjeta per terheqje guresh*** *- Artikujt me Nr. 42 - 46 eshte kerkuar te paraqitet moster specifike per artikullin Nr. 44. Autoriteti Kontraktor kerkon specifikisht vetem moster per artikullin Nr. 44 nderkohe qe te gjithe artikujt e kesaj kategorie produktesh kane te njejtat karakteristika funksionale dhe ndryshojne vetem madhesite. Kerkesa per master specifike per artikullin Nr. 44 eshte diskriminuese sepse favorizon vetem*

*operatorin ekonomik i cili e ka gjendje ate shporte me madhesi specifike. Rrjedhimisht kerkojme qe te paraqitet vetem nje moster Rrjeta per terheqje guresh me dimensione te perfshire ne nje nga Artikujt Nr. 42 deri ne Nr. 46 sepse prania e dimensioneve te tjera te kerkuara mund te verifikohet jo vetem me dokumentat teknike te prodhuesit por edhe nepermjet ofertes teknike qe i kerkohet te paraqese operatorit ekonomik.* ***Ballona Ekstraktimi Biliare*** *- Artikujt me Nr. 47 - 52 jane kerkuar te paraqiten dy mostra, perkatesisht artikujt Nr. 48 dhe Nr. 51. Dy artikujt e kerkuar si mostra nuk kane asgje me specifike se artikujt e tjere te kesaj kategorie pervec; madhesive. Kerkesa per mostra specifike per artikujt Nr. 48 dhe Nr. 51 eshte diskriminuese sepse favorizon vetem operatorin ekonomik i cili i ka gjendje ato dy mostra me madhesi specifike. Rrjedhimisht kerkojme qe te paraqitet vetem nje master Ballona Ekstraktimi Biliare me dimensione te perfshire ne nje nga Artikujt Nr. 47 deri ne Nr. 52 sepse prania e dimensioneve te tjera te kerkuara mund te verifikohet jo vetem me dokumentat teknike te prodhuesit por edhe nepermjet ofertes teknike qe i kerkohet te paraqese operatorit ekonomik.* ***Ballon dilatacioni me multi stage*** *- Artikujt me Nr. 55 - 60 eshte kerkuar te paraqitet moster specifike per artikullin Nr. 58. Eshte e pakuptueshme pse Autoriteti Kontraktor kerkon specifikisht vetem moster per artikullin Nr. 58 nderkohe qe te gjithe artikujt e kesaj kategorie produktesh kane te njejtat karakteristika funksionale dhe ndryshojne vetem madhesite. Kerkesa per moster specifike per artikullin Nr. 58 eshte diskriminuese sepse favorizon vetem operatorin ekonomik i cili e ka gjendje ate Ballon me madhesi specifike. Rrjedhimisht. kerkojme qe te paraqitet vetem nje moster Ballon dilatacioni me multi stage me dimensione te perfshire ne nje nga Artikujt Nr. 55 deri ne Nr. 60 sepse prania e dimensioneve te tjera te kerkuara mund te verifikohet jo vetem me dokumentat teknike te prodhuesit por edhe nepermjet ofertes teknike qe i kerkohet te paraqese operatorit ekonomik.* ***Pistolete fryrese*** *- Artikulli Nr. 61 eshte kerkuar te paraqitet moster nderkohe qe sasia e kerkuar eshte vetem 3 cope. Evidentojme faktin qe ky produkt ka kosto te larte dhe sasia e kerkuar ne kete procedure nuk e justifikon kerkesen per nje moster. Gjithashtu, karakteristikat teknike dhe funksionale te pajisjes mund te verifikohen fare mire nepermjet dokuementave teknike te prodhuesit pa pasur nevoje per moster. Rrjedhimisht kerkojme qe te hiqet kerkesa per moster per kete artikull.* ***Klipe hemostatike gastrointestinale*** *- Artikujt me Nr. 62 - 67 eshte kerkuar te paraqitet moster specifike per artikullin Nr. 64 i cili ka te njejtat karakteristika funksionale me artikujt e tjere Nr. 62 deri ne Nr. 67. Eshte e pakuptueshme pse Autoriteti Kontraktor kerkon specifikisht vetem moster per artikullin Nr. 64. Kerkesa per moster specifike per artikullin Nr. 64 eshte diskriminuese sepse favorizon vetem operatorin ekonomik i cili e ka gjendje ate Klip hemostatik me madhesi specifike. Rrjedhimisht kerkojme qe te paraqitet vetem nje moster Klipe hemostatike gastrointestinale me dimensione te perfshire ne nje nga Artikujt Nr. 62 deri ne Nr. 67 sepse prania e dimensioneve te tjera te kerkuara mund te verifikohet jo vetem me dokumentat teknike te prodhuesit por edhe nepermjet ofertes teknike qe i kerkohet te paraqese operatorit ekonomik.* ***Ligature varicesh ezofagal*** *- Artikujt me Nr. 68 - 69 eshte kerkuar te paraqitet moster specifike per artikullin Nr. 69 nderkohe qe edhe artikulli Nr. 68 ka te njejtat karakteristika funksionale pervec dimensioneve. Kerkesa per moster specifike per artikullin Nr. 69 eshte diskriminuese sepse favorizon vetem operatorin ekonomik i cili e ka gjendje ate Ligature varicesh ezofageale me madhesi specifike. Rrjedhimisht kerkojme qe te paraqitet vetem nje moster Ligature varicesh ezofagal me dimensione te perfshire ne nje nga Artikuit Nr. 68 ose Nr. 69 sepse prania e dimensioneve te*

*tjera te kerkuara mund te verifikohet jo vetem me dokumentat teknike te prodhuesit por edhe nepermjet ofertes teknike qe i kerkohet te paraqese operatorit ekonamik.* ***Age skleroterapie*** *- Artikujt me Nr. 70 - 77 jane kerkuar te paraqiten dy mostra, perkatesisht artikujt Nr. 70 dhe Nr. 75. Dy artikujt e kerkuar si mostra nuk kane asgje me specifike se artikujt e tjere te kesaj kategorie pervec madhesive. Kerkesa per mostra specifike per artikujt Nr. 70 dhe Nr. 75 eshte diskriminuese sepse favorizon vetem operatorin ekonomik i cili i ka gjendje ato dy mostra me madhesi specifike. Rrjedhimisht kerkojme qe te paraqitet vetem nje moster Age skleroterapie me dimensione te perfshire ne nje nga Artikujt Nr. 70 deri ne Nr. 77 sepse prania e dimensioneve te tjera te kerkuara mund te verifikohet jo vetem me dokumentat teknike te prodhuesit por edhe nepermjet ofertes teknike qe i kerkohet te paraqese operatorit ekonomik.* ***Forceps biopsie*** *= Artikujt me Nr. 80 - 83 jane kerkuar te paraqiten mostra per te gjithe keto artikuj. Evidentojme faktin qe te katert artikuj Nr. 80 - 83 kane karakteristika funksionale te njejta dhe ndryshon vetem gjatesia e tyre. Kerkesa per mostra specifike per te gjithe artikujt Nr. 80 - 83 eshte diskriminuese sepse favorizon vetem operatorin ekonomik i cili i ka gjendje ato kater mostra me madhesi specifike. Rrjedhimisht kerkojme qe te paraqitet vetem nje moster Forceps biopsie me dimensione ose karakteristika te perfshira ne nje nga Artikujt Nr. 80 deri ne Nr. 83 sepse prania e dimensioneve dhe karakteristikave te tjera te kerkuara mund te verifikohet jo vetem me dokumentat teknike te prodhuesit por edhe nepermjet ofertes teknike qe i kerkohet te paraqese operatorit ekonomik.* ***Ngjites per varicet ezofageale dhe fundale*** *- Artikulli Nr. 85 eshte kerkuar te paraqitet moster nderkohe qe sasia e kerkuar eshte vetem 10 cope. Evidentojme faktin qe karakteristikat e ketij produkti nuk mund te verifikohen nepermjet mostres por nepermjet dokumentave teknike te prodhuesit pa pasur nevoje per moster. Mostra eshte vetem nje tubete dhe kerkesa per paraqitjen e saj vetem sa veshtireson dhe dekurajon pjesemarrjen e operatoreve ekonomike te cilet nuk e kane gjendje kete produkt. Rrjedhimisht kerkojme qe te hiqet kerkesa per moster per kete artikull.*

*Cdo kerkese per me shume se nje moster per nje kategori produkti do te ishte nje abuzim me percaktimin e Ligjit te Prokurimit Publik, Neni 23 dhe shkelje e parimeve baze te Ligjit te Prokurimit Publik, neni 1, Pika 2. Kerkesa e pajustifikuar e me shume se nje mostre per nje kategori produkti dhe kerkesa per mostra te artikujve me sasi te vogel ul efikasitetin e procedures se prokurimit, rrit shpenzimet proceduriale, dekurajon pjesemarrjen e operatoreve ekonomike, ul konkurrencen, dhe te gjitha keto perbejne trajtim te pabarabarte dhe diskriminues te operatoreve ekonomike te interesuar per te marre pjese ne gare.",* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në dokumentat e tenderit, shtojca 9/2, "*Kriteret e Vecanta të Kualifikimit*", në pikën 2.3.b " *Për Kapacitetin teknik*" nga ana e autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri si më poshtë:

*"b) Per te gjithe artikujt e ofertuar me shenjen asterisko (*) tek nr, duhet te paraqiten mostra diten e hapjes se ofertave, me date __.__.2021 ne oren 10:00. Dorezimi i kampioneve/mostrave, te behet prane Drejtorise Juridike/Sektori Prokurimeve, QSUT "Nene Tereza", te mbyllura ne nje zarf /kuti jo transparente te vulosur mbi te cilin te shenohet:*

- *“Mos e hapni me përjashtim te rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit te Ofertave te procedurës se prokurimit « ……… » dhe jo para datës ___.___ .2021, ora 10:00.*
- *Se bashku me mostrat ofertuesi duhet te japë edhe një shkrese te vulosur dhe firmosur ku te listohen mostrat qe ndodhen ne zarf/kuti.*
- *Mbi çdo mostër te dorëzuar, ofertuesi duhet te shënoje Nr.Rendor te Artikullit qe përfaqëson.*

*Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë te shoqëruara me listën e inventarizimit dhe te identifikuara sipas Nr. Rendor, nëse ka mungesa mostrash për artikuj te veçante, atëherë oferta do te quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do te s’kualifikohet.*

III.2.2. Në dokumentat e tenderit, shtojca 10, “*Specifikimet Teknike*”, dhe shtojcën 12 “*Sasia dhe Grafiku i Lëvrimit*” nga ana e autoriteti kontraktor është përcaktuar si më poshtë:

| Nr. | Emertimi | Njësia | Sasia |
|---|---|---|---|
| 1 | Gide hidrofilike per ERCP, material Nitinoli, me maje atraumatike,radiopak Diametri 0.035" gjatesia e punes 4500-4510mm, gjatesia e majes 60 mm, maje e drejte | Cope | 10 |
| 2* | Gide hidrofilike per ERCP, material Nitinoli, me maje atraumatike,radiopak Diametri 0.035", gjatesia e punes 4500-4510mm, gjatesia e majes 60-62 mm, maje ne forme J | Cope | 5 |
| 3 | Gide hidrofilike per ERCP, material Nitinoli, me maje atraumatike, radiopak Diametri 0.025", gjatesia e punes 4500-4510mm, gjatesia e majes 60-62mm, maje e drejte | Cope | 5 |
| 4 | Gide hidrofilike per ERCP, material Nitinoli, me maje atraumatike,radiopak Diametri 0.025", gjatesia e punes 4500-4510mm, gjatesia e majes 60-62 mm, maje ne forme J | Cope | 5 |
| 5* | Gide hidrofilike per ERCP, material Nitinoli, me maje atraumatike,radiopak Diametri 0.021", gjatesia e punes 4500-4510mm, gjatesia e majes 60-62mm, maje e drejte | Cope | 5 |
| 6 | Gide hidrofilike per ERCP, material Nitinoli, me maje atraumatike,radiopak Diametri 0.018", gjatesia e punes 4500-4510mm, gjatesia e majes 60-62mm, maje e drejte | Cope | 5 |
| 7 | Gide hidrofilike per ERCP klasike, material Nitinoli, me maje atraumatike,radiopak, diametri 0.035", gjatesia e punes 4200-4210mm, gjatesia e majes 130-135mm, | Cope | 5 |
| 8 | Papapilotom, gjatesia e punes 2000-2010mm, diametri i jashtem 2.5-2.55mm, me guide ëire te paravendosur, kanali i punes 2.8mm, teli preres te jete pjeserisht i veshur, me maje atraumatike, me 3 lumen gjatesia e majes 0, gjatesia e telit preres 20-22mm | Cope | 5 |
| 9* | Papapilotom, gjatesia e punes 2000-2010mm, diametri i jashtem 2.5-2.55mm, me guide ëire te paravendosur, kanali i punes 2.8mm, teli preres te jete pjeserisht i veshur, me maje atraumatike, me 3 lumen gjatesia e majes 0, gjatesia e telit preres 24-26mm | Cope | 5 |
| 10 | Papapilotom, gjatesia e punes 2000-2010mm, diametri i jashtem 2.5-2.55mm, me guide ëire te paravendosur, kanali i punes 2.8mm, teli preres te jete pjeserisht i veshur, me maje atraumatike, me 3 lumen gjatesia e majes 0, gjatesia e telit preres 29-31mm | Cope | 5 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 11 | Papapilotom, gjatesia e punes 2000-2010mm, diametri i jashtem 2.5-2.55mm, me guide ëire te paravendosur, kanali i punes 2.8mm, teli preres te jete pjeserisht i veshur, me maje atraumatike, me 3 lumen gjatesia e majes 2-2.2mm, gjatesia e telit preres 20-22mm | Cope | 5 |
| 12 | Papapilotom, gjatesia e punes 2000-2010mm, diametri i jashtem 2.5-2.55mm, me guide ëire te paravendosur, kanali i punes 2.8mm, teli preres te jete pjeserisht i veshur, me maje atraumatike, me 3 lumen gjatesia e majes 2-2.2mm, gjatesia e telit preres 24-26mm | Cope | 10 |
| 13 | Papapilotom, gjatesia e punes 2000-2010mm, diametri i jashtem 2.5-2.55mm, me guide ëire te paravendosur, kanali i punes 2.8mm, teli preres te jete pjeserisht i veshur, me maje atraumatike, me 3 lumen gjatesia e majes 2-2.2mm, gjatesia e telit preres 29-31mm | Cope | 5 |
| 14 | Papapilotom, gjatesia e punes 2000-2010mm, diametri i jashtem 2.5-2.55mm, me guide ëire te paravendosur, kanali i punes 2.8mm, teli preres te jete pjeserisht i veshur, me maje atraumatike, me 3 lumen gjatesia e majes 5-5.3mm, gjatesia e telit preres 20-22mm | Cope | 5 |
| 15 | Papapilotom, gjatesia e punes 2000-2010mm, diametri i jashtem 2.5-2.55mm, me guide ëire te paravendosur, kanali i punes 2.8mm, teli preres te jete pjeserisht i veshur, me maje atraumatike, me 3 lumen gjatesia e majes 5-5.3mm, gjatesia e telit preres 24-26mm | Cope | 10 |
| 16 | Papapilotom, gjatesia e punes 2000-2010mm, diametri i jashtem 2.5-2.55mm, me guide ëire te paravendosur, kanali i punes 2.8mm, teli preres te jete pjeserisht i veshur, me maje atraumatike, me 3 lumen gjatesia e majes 5-5.3mm, gjatesia e telit preres 29-31mm | Cope | 5 |
| 17* | Papapilotom, gjatesia e punes 2000-2010mm, diametri i jashtem 2.5-2.55mm, me guide ëire te paravendosur, kanali i punes 2.8mm, teli preres te jete pjeserisht i veshur, me maje atraumatike me 3 lumen, me age thike, gjatesia e ages 5-5.5mm | Cope | 10 |
| 18 | Papapilotom, gjatesia e punes 2000-2010mm, diametri i jashtem 2.5-2.55mm, me guide ëire te paravendosur, kanali i punes 2.8mm, teli preres te jete pjeserisht i veshur, me maje atraumatike me 3 lumen, me age thike, gjatesia e ages 7-7.5mm | Cope | 5 |
| 19 | Stente biliare, material PE, 2 carje ne 2 fundet per siguruar fiksimin me migrim minimal, vizible nga rrezet X, me 2 vrima anesore, diametri i jashtem 7-7.5Fr, me gjatesi 5cm; 7cm ;10cm, me forme pigtail ne te dy anet | Cope | 5 |
| 20 | Stente biliare, material PE, 2 carje ne 2 fundet per siguruar fiksimin me migrim minimal, vizible nga rrezet X, me 2 vrima anesore, diametri i jashtem 7-7.5Fr, me gjatesi 5cm; 7cm ;10cm, e harkuar 15° | Cope | 10 |
| 21* | Stente biliare, material PE, 2 carje ne 2 fundet per siguruar fiksimin me migrim minimal, vizible nga rrezet X, me 2 vrima anesore, diametri i jashtem 8-8.5Fr, me gjatesi 5cm; 7cm ;10cm, e harkuar 15° | Cope | 10 |
| 22 | Stente biliare, material PE, 2 carje ne 2 fundet per siguruar fiksimin me migrim minimal, vizible nga rrezet X, me 2 vrima anesoreDiametri i jashtem 10-10.5Fr, me gjatesi 5cm; 7cm ;10cm, e harkuar 15° | Cope | 10 |
| 23 | Stenta biliare, material PE, 2 carje ne 2 fundet per siguruar fiksimin me migrim minimal, vizible nga rrezet X, me 2 vrima anesore, diametri i jashtem 7-7.5Fr, me gjatesi 5cm; 7cm ;10cm, me perkulje laterale 45° | Cope | 5 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 24 | Stenta biliare, material PE, 2 carje ne 2 fundet per siguruar fiksimin me migrim minimal, vizible nga rrezet X, me 2 vrima anesore, diametri i jashtem 8-8.5Fr, me gjatesi 5cm; 7cm ;10cm,me perkulje laterale 45° | Cope | 5 |
| 25 | Stenta biliare, material PE, 2 carje ne 2 fundet per siguruar fiksimin me migrim minimal, vizible nga rrezet X, me 2 vrima anesore, diametri i jashtem 10-10.5Fr, me gjatesi 5cm; 7cm ;10cm, me perkulje laterale 45° | Cope | 5 |
| 26 | Introducer , diameter 7-7.5Fr, gjatesia 220-225cm, gjatesia e kateterit te gides 40-42cm | Cope | 20 |
| 27* | Introducer , diameter 8-8.5Fr, gjatesia 220-225cm, gjatesia e kateterit te gides 40-42cm | Cope | 15 |
| 28 | Introducer , diameter 10-10.5Fr, gjatesia 220-225cm, gjatesia e kateterit te gides 40-42cm | Cope | 15 |
| 29 | Stente Biliare / Pankreatike e biodegradueshme ne 12-13 dite , gjatesia 80-82mm, diametri 6 Fr | Cope | 2 |
| 30 | Stente Biliare / Pankreatike e biodegradueshmene 12-13 dite , gjatesia 80-82mm, diametri 8 Fr | Cope | 2 |
| 31 | Stente Biliare / Pankreatike e biodegradueshme ne 12-13 dite , gjatesia 80-82mm, diametri 10 Fr | Cope | 2 |
| 32 | Stente Biliare / Pankreatike e biodegradueshme ne 19-21dite , gjatesia 80-82mm, diametri 6 Fr | Cope | 2 |
| 33 | Stente Biliare / Pankreatike e biodegradueshme ne 19-21dite , gjatesia 80-82mm, diametri 8 Fr | Cope | 2 |
| 34 | Stente Biliare / Pankreatike e biodegradueshmene 19-21dite , gjatesia 80-82mm, diametri 10 Fr | Cope | 2 |
| 35 | Stente Biliare / Pankreatike e biodegradueshme ne 11-12jave, gjatesia 80-82mm, diametri 6 Fr | Cope | 2 |
| 36 | Stente Biliare / Pankreatike e biodegradueshme ne 11-12jave, gjatesia 80-82mm, diametri 8 Fr | Cope | 2 |
| 37 | Stente Biliare / Pankreatike e biodegradueshme ne 11-12jave, gjatesia 80-82mm, diametri 10 Fr | Cope | 2 |
| 38 | Shporte per thyerje dhe terheqje guresh biliare, maje atraumatike, gjatesia e litarit terheqes 200-205cm, multifilament, me madhesi hapje 1.5-1.6 cm | Cope | 2 |
| 39* | Shporte per thyerje dhe terheqje guresh biliare, maje atraumatike, gjatesia e litarit terheqes 200-205cm, multifilament, me madhesi hapje 2-2.1 cm | Cope | 2 |
| 40 | Shporte per thyerje dhe terheqje guresh biliare, maje atraumatike, gjatesia e litarit terheqes 200-205cm, multifilament, me madhesi hapje 3-3.1 cm | Cope | 2 |
| 41 | Shporte per thyerje dhe terheqje guresh biliare, maje atraumatike, gjatesia e litarit terheqes 200-205cm, multifilament, me madhesi hapje 3.5-3.6 cm | Cope | 2 |
| 42 | Rrjeta per terheqje guresh, rrotullim 360°, madhesia e rrjetes 22-23 mm; kateteri 2.5-2.6mm; gjatesia 230-233cm; kanali punes 2.8mm | Cope | 3 |
| 43 | Rrjeta per terheqje guresh, rrotullim 360°, madhesia e rrjetes 26-28 mm; kateteri 2.5-2.6mm; gjatesia 230-233cm; kanali punes 2.8mm | Cope | 3 |
| 44* | Rrjeta per terheqje guresh, rrotullim 360°, madhesia e rrjetes 31-33 mm; kateteri 2.5-2.6mm; gjatesia 230-233cm; kanali punes 2.8mm | Cope | 3 |
| 45 | Rrjeta per terheqje guresh, rrotullim 360°, madhesia e rrjetes 15-16 | Cope | 3 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | mm; kateteri 1.6-1.8mm; gjatesia 120-123cm; kanali punes 2.0mm | | |
| 46 | Rrjeta per terheqje guresh, rrotullim 360°, madhesia e rrjetes 15-16 mm; kateteri 1.6-1.8mm; gjatesia 160-163cm; kanali punes 2.0mm | Cope | 3 |
| 47 | Ballona Ekstraktimi Biliare, me 3 lumen, me maje konike atraumatike, gjatesia e punes 2000-2010mm, te jete e dukshme ne rreze X, balona te fryhet me 3 shkalle, diametri i fryrjes te pakten 9-15mm, injektimi i kontrastit pas ballonit (distale) | Cope | 15 |
| 48* | Ballona Ekstraktimi Biliare, me 3 lumen, me maje konike atraumatike, gjatesia e punes 2000-2010mm, te jete e dukshme ne rreze X, balona te fryhet me 3 shkalle, diametri i fryrjes te pakten 12-18mm, injektimi i kontrastit pas ballonit (distale) | Cope | 15 |
| 49 | Ballona Ekstraktimi Biliare, me 3 lumen, me maje konike atraumatike, gjatesia e punes 2000-2010mm, te jete e dukshme ne rreze X, balona te fryhet me 3 shkalle, diametri i fryrjes te pakten 15-21mm, injektimi i kontrastit pas ballonit (distale) | Cope | 15 |
| 50 | Ballona Ekstraktimi Biliare, me 3 lumen, me maje konike atraumatike, gjatesia e punes 2000-2010mm, te jete e dukshme ne rreze X, balona te fryhet me 3 shkalle, diametri i fryrjes te pakten 9-15mm, injektimi i kontrastit para ballonit (proksimale) | Cope | 5 |
| 51* | Ballona Ekstraktimi Biliare, me 3 lumen, me maje konike atraumatike, gjatesia e punes 2000-2010mm, te jete e dukshme ne rreze X, balona te fryhet me 3 shkalle, diametri i fryrjes te pakten 12-18mm, injektimi i kontrastit para ballonit (proksimale) | Cope | 5 |
| 52 | Ballona Ekstraktimi Biliare, me 3 lumen, me maje konike atraumatike, gjatesia e punes 2000-2010mm, te jete e dukshme ne rreze X, balona te fryhet me 3 shkalle, diametri i fryrjes te pakten 15-21mm, injektimi i kontrastit para ballonit (proksimale) | Cope | 5 |
| 53 | Ballona dilatacioni, me maje konike, me dilacion konstant ne te gjithe gjatesine, me 2 shenime te dukshme nga rrezet X ne 2 krahet e kunderta, kanali i punes 2.8mm, gjatesia e kateterit 1800-1810mm, balloni me diameter 8-9mm dhe gjatesi 55-57mm | Cope | 5 |
| 54 | Ballona dilatacioni, me maje konike, me dilacion konstant ne te gjithe gjatesine, me 2 shenime te dukshme nga rrezet X ne 2 krahet e kunderta, kanali i punes 2.8mm, gjatesia e kateterit 1800-1810mm, balloni me diameter 10-11mm dhe gjatesi 55-57mm | Cope | 5 |
| 55 | Ballon dilatacioni me multi stage, 3 diametra me 3 nivele te ndara presioni, me 2 shenime te dukshme nga rrezet X ne 2 krahet e kunderta, me maje konike atraumatike, me tel te ngurtesuar e paravendosur, me maje hidrofilike radiopak, kanali i punes 2.8mm, gjatesia e kateterit 1800-1810mm, me tre nivele fryrjeje te pakten 6-8mmm, gjatesia balonit 55-57mm | Cope | 2 |
| 56 | Ballon dilatacioni me multi stage, 3 diametra me 3 nivele te ndara presioni, me 2 shenime te dukshme nga rrezet X ne 2 krahet e kunderta, me maje konike atraumatike, me tel te ngurtesuar e paravendosur, me maje hidrofilike radiopak, kanali i punes 2.8mm, gjatesia e kateterit 1800-1810mm, me tre nivele fryrjeje te pakten 8-10mm, gjatesia balonit 55-57mm | Cope | 2 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 57 | Ballon dilatacioni me multi stage, 3 diametra me 3 nivele te ndara presioni, me 2 shenime te dukshme nga rrezet X ne 2 krahet e kunderta, me maje konike atraumatike, me tel te ngurtesuar e paravendosur, me maje hidrofilike radiopak, kanali i punes 2.8mm, gjatesia e kateterit 1800-1810mm, me tre nivele fryrjeje te pakten 10-12mm, gjatesia balonit 55-57mm | Cope | 2 |
| 58* | Ballon dilatacioni me multi stage, 3 diametra me 3 nivele te ndara presioni, me 2 shenime te dukshme nga rrezet X ne 2 krahet e kunderta, me maje konike atraumatike, me tel te ngurtesuar e paravendosur, me maje hidrofilike radiopak, kanali i punes 2.8mm, gjatesia e kateterit 1800-1810mm, me tre nivele fryrjeje te pakten 12-15mm, gjatesia balonit 55-57mm | Cope | 2 |
| 59 | Ballon dilatacioni me multi stage, 3 diametra me 3 nivele te ndara presioni, me 2 shenime te dukshme nga rrezet X ne 2 krahet e kunderta, me maje konike atraumatike, me tel te ngurtesuar e paravendosur, me maje hidrofilike radiopak, kanali i punes 2.8mm, gjatesia e kateterit 1800-1810mm, me tre nivele fryrjeje te pakten 15-18mm, gjatesia balonit 55-57mm | Cope | 2 |
| 60 | Ballon dilatacioni me multi stage, 3 diametra me 3 nivele te ndara presioni, me 2 shenime te dukshme nga rrezet X ne 2 krahet e kunderta, me maje konike atraumatike, me tel te ngurtesuar e paravendosur, me maje hidrofilike radiopak, kanali i punes 2.8mm, gjatesia e kateterit 1800-1810mm, me tre nivele fryrjeje te pakten 18-20mm, gjatesia balonit 55-57mm | Cope | 2 |
| 61* | Pistolete fryrese, per fryrjen dhe shfryrjen e ballonave te dilatacionit dhe balonit multi-stage, me mekanizem quick-lock per shfryrje te shpejte, me mates te presionit. | Cope | 3 |
| 62 | Klipe hemostatike gastrointestinale, me rrotullim 360°, pa limit hapjesh e mbyllje, diametri i klipit 2.6mm, kendi i hapjes 135°, me gjatesi pune 195-200 cm;hapja e nofullave 8-8,5mm | Cope | 15 |
| 63 | Klipe hemostatike gastrointestinale, me rrotullim 360°, pa limit hapjesh e mbyllje, diametri i klipit 2.6mm, kendi i hapjes 135°, me gjatesi pune 230-235 cm; hapja e nofullave 8-8,5mm | Cope | 10 |
| 64* | Klipe hemostatike gastrointestinale, me rrotullim 360°, pa limit hapjesh e mbyllje, diametri i klipit 2.6mm, kendi i hapjes 135°, me gjatesi pune 195-200 cm; hapja e nofullave 11-12mm | Cope | 15 |
| 65 | Klipe hemostatike gastrointestinale, me rrotullim 360°, pa limit hapjesh e mbyllje, diametri i klipit 2.6mm, kendi i hapjes 135°, me gjatesi pune 230-235 cm; hapja e nofullave 11-12mm | Cope | 10 |
| 66 | Klipe hemostatike gastrointestinale, me rrotullim 360°, pa limit hapjesh e mbyllje, diametri i klipit 2.6mm, kendi i hapjes 135°, me gjatesi pune 195-200 cm; hapja e nofullave 16-17mm | Cope | 5 |
| 67 | Klipe hemostatike gastrointestinale, me rrotullim 360°, pa limit hapjesh e mbyllje, diametri i klipit 2.6mm, kendi i hapjes 135°, me gjatesi pune230-235 cm; hapja e nofullave 16-17mm | Cope | 10 |
| 68 | Ligature varicesh ezofagal, kanali i punes 2.8mm, te jete me 6 ligatura, material pa latex, gjatesia 1450mm, diametri i endoskopit 9.4-13mm | Cope | 5 |
| 69* | Ligature varicesh ezofagal, kanali i punes 2.8mm, te jete me 6 ligatura, material pa latex, gjatesia 1900mm, diametri i endoskopit 11-14mm | Cope | 5 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 70* | Age skleroterapie, Sheath me diameter 2.3mm, age 22G dhe zgjatim te ages deri ne 4 mm gjatesi 180-185cm | Cope | 220 |
| 71 | Age skleroterapie , sheath me diameter 2.3mm, age 25G dhe zgjatim te ages deri ne 4 mm gjatesi 180-185cm | Cope | 20 |
| 72 | Age skleroterapie , sheath me diameter 2.3mm, age 22G dhe zgjatim te ages deri ne 4 mm gjatesi 200-205cm | Cope | 10 |
| 73 | Age skleroterapie , sheath me diameter 2.3mm, age 25G dhe zgjatim te ages deri ne 4 mm gjatesi 200-205cm | Cope | 10 |
| 74 | Age skleroterapie , sheath me diameter 2.3mm, age 22G dhe zgjatim te ages deri ne 4 mm gjatesi 230-235cm | Cope | 10 |
| 75* | Age skleroterapie , sheath me diameter 2.3mm, age 25G dhe zgjatim te ages deri ne 4 mm gjatesi 230-235cm | Cope | 50 |
| 76 | Age skleroterapie , sheath me diameter 2.3mm, age 22G dhe zgjatim te ages deri ne 6 mm gjatesi 180-185cm | Cope | 10 |
| 77 | Age skleroterapie , sheath me diameter 2.3mm, age 25G dhe zgjatim te ages deri ne 6 mm gjatesi 230-235cm | Cope | 10 |
| 78* | Age aspirative EUS 22G, sheath 1.8-1.9mm, gjatesia maksimale e ages 80mm, kanali punes 2.8mm, gjatesia e punes: 1375-1415mm | Cope | 70 |
| 79* | Age biopsie EUS 22G, sheath 1.8-1.9, gjatesia maksimale e ages 80mm kanali punes 2.8mm gjatesia e punes 1375mm- 1415mm | Cope | 50 |
| 80* | Forceps biopsie, kanali i punes 2.3mm, gjatesia 180-185cm, me veshje nofulla standarte/ ovale | Cope | 30 |
| 81* | Forceps biopsie, kanali i punes 2.3mm, gjatesia 180-185cm, me veshje nofulla standarte/ ovale me spike | Cope | 40 |
| 82* | Forceps biopsie, kanali i punes 2.3mm, gjatesia 230-235cm, me veshje nofulla standarte/ ovale | Cope | 30 |
| 83* | Forceps biopsie, kanali i punes 2.3mm, jatesia 230-235cm, me veshje nofulla standarte/ ovale me spike | Cope | 30 |
| 84 | Kit PEG gastrostomie 20-24Fr, pull | Cope | 10 |
| 85* | Ngjites per varicet ezofageale dhe fundale, me perberje monomeric n-butyl-2-cyanoacrylate, paketim 0.5ml | Cope | 10 |
| 86 | Stent Esofageal, material Nitinoli, me vete hapje, me veshje te pjesshme, me valvul antirefluks, diametri qendror 20mm diametri fundor 26mm gjatesia 100-105mm | Cope | 2 |
| 87 | Stent Esofageal, material Nitinoli, me vete hapje, me veshje te pjesshme, me valvul antirefluks, diametri qendror 20mm diametri fundor 26mm gjatesia 120-125mm | Cope | 2 |
| 88 | Stent Esofageal, material Nitinoli, me vete hapje, me veshje te pjesshme, me valvul antirefluks, diametri qendror 24mm diametri fundor 26mm gjatesia 100-105mm | Cope | 2 |
| 89 | Stent Esofageal, material Nitinoli, me vete hapje, me veshje te pjesshme, me valvul antirefluks, diametri qendror 24mm diametri fundor 26mm gjatesia 120-125mm | Cope | 2 |
| 90 | Stent biliar me vetehapje, material Nitinoli me funde atraumatike, radiopak, introducer te paravendosur, te vendoset nepermjet endosopit i paveshur , diametri i trupit 10mm, gjatesia 40mm dhe 60mm, gjatesia e introducer 1800mm, | Cope | 2 |
| 91 | Stent biliar me vetehapje, material Nitinoli me funde atraumatike, radiopak, introducer te paravendosur, te vendoset nepermjet endosopit, gjysem i veshur, diametri i trupit 10mm, gjatesia 60mm, gjatesia e introducer 1800mm, | Cope | 2 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 92 | Stent biliar me vetehapje, material Nitinoli me funde atraumatike, radiopak, introducer te paravendosur, te vendoset nepermjet endosopit i veshur , diametri i trupit 10mm, gjatesia 40mm dhe 60mm, gjatesia e introducer 1800mm, | Cope | 2 |
| 93 | Boje markuese gastrointestinale me shiringe jo me te vogel se 5ml | Cope | 10 |

III.2.3. Në nenin 46, pika 1 e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se : *"[...]Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [...]"*

III.2.4. Referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*", neni 27 "*Kontratat e mallrave*", pika 6 përcaktohet *"Autoriteti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

*a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*
*b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose*
*c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

III.2.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve.

Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kritereve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjestim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP-së.

III.2.6. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kritereve të veçanta të kualifikimit mostrat e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proprocion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së. Në rastin konkret K.P.P. konstaton se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës. KPP konstaton se për përmbushjen e synimit të këtij autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit kritere kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimit të specifikimeve teknike të produkteve me anë të dorëzimit të mostrave. Në këto kushte, KPP gjykon se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor mbi dorëzimin e mostrave është në përputhje me nenin 27 pika 6 gërma “a” të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, kërkesa për dorëzimin e një mostre më specifikime të ndryshme por të së njëjtës kategori produktesh nuk është një kërkesë e ekzagjeruar, por përkundrazi është në përputhje me natyrën, përmasat e objektit të prokurimit. Konstatohet se, autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar mostra për çdo produkt të së njëjtës kategori, por ka kërkuar mostra të së njëjtës kategori produktesh por që kanë përmasë dhe specifika të ndryshme. Operatori ekonomik ankimues në pretendimet e ngritura në ankëse nuk argumenton në asnjë moment se kriteri për paraqitjen e mostrave të me përmasa dhe specifikime të ndryshme por të së njëjtës kategori, ka një kosto të konsiderushme ekonomike, dhe e ngarkon me një kosto financiare të rëndë të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar për këtë procedurë prokurimi që në fazën e hartimit dhe përgatitjes së ofertave, një gjë e tillë nuk është argumentuar nga ana e operatorit ekonomik, gjithashtu autoriteti kontraktor nuk mund të përcaktojë një diapazon të lirë në lidhje me dorzimin e mostrave për produktet brënda të njëjtës kategori por që në vetëvete kanë përmasa dhe specifika të ndryshme ashtu sikurse pretendon dhe ankimuesi, pasi në përcaktim i tillë do të sillte pabarazi në vlersimin e mostrave nga ana e autoritetit kontraktor pasi operatorë të ndryshëm do të vlerësoheshin për mostra të ndryshme. Kriteri i përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor në asnjë prej artikujve nuk e humbet nocionin e kërkesës për mostra, në kushtet kur, sasia e kërkuar nga autoriteti kontraktor p.sh. për një kategori produktesh është 18 (tetëmbëdhjetë), ndërsa sasia e mostrave të kërkuara është 4 (katër), apo kur sasia e kërkuar nga autoriteti kontraktor është 7 (shtatë) ndërsa sasia e mostrave të kërkuara është 1 (një), etj., pra vlera totale e mostrave të paraqitura nuk i ngarkon me një kosto financiare të rëndë të gjithë

operatorët ekonomikë të interesuar për këtë procedurë prokurimi që në fazën e hartimit dhe përgatitjes së ofertave. KPP gjykon se përcaktimi për mostrat në mënyrën e hartuar si më sipër, nuk është një kërkesë e ekzagjeruar dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Në interpretimin teleologjik (qëllimit) të dispozitës së sipërcituar, KPP gjykon se, qëllimi i vendosur nga ligjvënësi për paraqitjen e mostrave, është dhënia e mundësisë së autoritetit kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, të kryerjes së verifikimeve (ekzaminim, inspektim, testim) të mostrave të dorëzuar nga operatorët ekonomikë në rast se këto të fundit janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruar në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit. Në rastin konkret Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor ka kërkuar mostra për produktet e prokuruara të cilat nuk janë të ekzagjeruara në numër dhe dorëzimi i mostrave është i rëndësishëm për autoritetin kontraktor në funksion të verifikimit të përpuethshmërisë së specifikimeve teknike me mostrat e dorëzuara me qëllim realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Sa më sipër KPP gjykon se kriteri për paraqitjen e mostrave është në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara, proporcionale me objektin e prokurimit dhe lehtësisht e mundur për tu përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "*Montal*" shpk nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*Montal*" sh.p.k. për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit, me argumentin si më poshtë vijon: "*Veme re se specifikimet teknike te pjeses dermuese te artikujve te kerkuar (82 artikuj nga 93 gjithesej) jane pergatitur ekskluzivisht ne forme "copy-paste" per produktet e prodhuesit kinez MICRO-TECH (Nanjing) Co., Ltd. (shih kodet e produkteve te paracaktuara ne Shtojcen A dhe kataloget perkates). Keto specifikime e bejne kete procedure nje gare te mbyllur paraprakisht duke favorizuar ekskluzivisht produkte te nje prodhuesi te panjohur dhe duke perjashtuar konkurrimin e produkteve me te mirenjohura per cilesine e larte te kesaj fushe siç jane produktet e prodhuesit prestigjoz amerikan Boston Scientific dhe prodhuesit prestigjoz gjerman KARL-STORZ, kompani te mirenjohura nderkornbetarisht te cilat perfaqesohen nga kompania MONTAL sh.p.k. ne Shqiperi. Per sa me siper kerkojme ndryshimin e specifikimeve teknike ne menyre te pershtatshme qe te permbushin parimet baze te LPP te cituara mesiper. Me konkretisht, ju lutemi te gjeni bashkengjitur Shtojcen - A, ku kemi listuar te gjithe specifikimet unike te cilat e bejne kete gare te pervetshme, si dhe propozimet tona konkrete per te kryer ndryshimet e specifikimeve unike, duke mundesuar hapjen e gares pa cenuar mundesine e konkurimit me produkte shume me cilesore se produktet e paracaktuara nga specifikimet aktuale te DST. Artikujt Nr. 29-37 - Stente Biliare/Pankreatike e biodegradueshme jane produkte unike boterore te prodhuesit AMG International i cili eshte pjese e kompanise Q3 Medical Devices. Sic u deshmua mesiper, artikujt Nr.29-37, jane produkte unike ne Bote dhe rrjedhimisht e bejne kete procedure prokurimi totalisht te mbyllur ne vetem nje operator ekonomik i cili perfaqeson prodhuesin MEDTRONIC ne Shqiperi. Per kete arsye, kerkojme qe keto produkte te vecohen nga lista e artikujve te tjere te tenderit dhe te prokurohen vecmas ne nje lot me vete, pa cenuar konkurencen e procedures aktuale. Te gjithe faktet e mesiperme e bejne kete procedure*

*prokurimi krejtesisht te mbyllur ne vetem nje operator ekonomik, duke cenuar legjitimitetin e pjesemarrjes se gjithe operatoreve te tjere ekonomike.*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1 Në dokumentat e tenderit, shtojca 10, "*Specifikimet teknike*" nga ana e autoriteti kontraktor është përcaktuar si më poshtë:

| Nr. | Emertimi | Njësia | Sasia |
|---|---|---|---|
| 1 | Gide hidrofilike per ERCP, material Nitinoli, me maje atraumatike,radiopak Diametri 0.035" gjatesia e punes 4500-4510mm, gjatesia e majes 60 mm, maje e drejte | Cope | 10 |
| 2* | Gide hidrofilike per ERCP, material Nitinoli, me maje atraumatike,radiopak Diametri 0.035", gjatesia e punes 4500-4510mm, gjatesia e majes 60-62 mm, maje ne forme J | Cope | 5 |
| 3 | Gide hidrofilike per ERCP, material Nitinoli, me maje atraumatike, radiopak Diametri 0.025", gjatesia e punes 4500-4510mm, gjatesia e majes 60-62mm, maje e drejte | Cope | 5 |
| 4 | Gide hidrofilike per ERCP, material Nitinoli, me maje atraumatike,radiopak Diametri 0.025", gjatesia e punes 4500-4510mm, gjatesia e majes 60-62 mm, maje ne forme J | Cope | 5 |
| 5* | Gide hidrofilike per ERCP, material Nitinoli, me maje atraumatike,radiopak Diametri 0.021", gjatesia e punes 4500-4510mm, gjatesia e majes 60-62mm, maje e drejte | Cope | 5 |
| 6 | Gide hidrofilike per ERCP, material Nitinoli, me maje atraumatike,radiopak Diametri 0.018", gjatesia e punes 4500-4510mm, gjatesia e majes 60-62mm, maje e drejte | Cope | 5 |
| 7 | Gide hidrofilike per ERCP klasike, material Nitinoli, me maje atraumatike,radiopak, diametri 0.035", gjatesia e punes 4200-4210mm, gjatesia e majes 130-135mm, | Cope | 5 |
| 8 | Papapilotom, gjatesia e punes 2000-2010mm, diametri i jashtem 2.5-2.55mm, me guide ëire te paravendosur, kanali i punes 2.8mm, teli preres te jete pjeserisht i veshur, me maje atraumatike, me 3 lumen gjatesia e majes 0, gjatesia e telit preres 20-22mm | Cope | 5 |
| 9* | Papapilotom, gjatesia e punes 2000-2010mm, diametri i jashtem 2.5-2.55mm, me guide ëire te paravendosur, kanali i punes 2.8mm, teli preres te jete pjeserisht i veshur, me maje atraumatike, me 3 lumen gjatesia e majes 0, gjatesia e telit preres 24-26mm | Cope | 5 |
| 10 | Papapilotom, gjatesia e punes 2000-2010mm, diametri i jashtem 2.5-2.55mm, me guide ëire te paravendosur, kanali i punes 2.8mm, teli preres te jete pjeserisht i veshur, me maje atraumatike, me 3 lumen gjatesia e majes 0, gjatesia e telit preres 29-31mm | Cope | 5 |
| 11 | Papapilotom, gjatesia e punes 2000-2010mm, diametri i jashtem 2.5-2.55mm, me guide ëire te paravendosur, kanali i punes 2.8mm, teli preres te jete pjeserisht i veshur, me maje atraumatike, me 3 lumen gjatesia e majes 2-2.2mm, gjatesia e telit preres 20-22mm | Cope | 5 |
| 12 | Papapilotom, gjatesia e punes 2000-2010mm, diametri i jashtem 2.5-2.55mm, me guide ëire te paravendosur, kanali i punes 2.8mm, teli preres te jete pjeserisht i veshur, me maje atraumatike, me 3 lumen gjatesia e majes 2-2.2mm, gjatesia e telit preres 24-26mm | Cope | 10 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 13 | Papapilotom, gjatesia e punes 2000-2010mm, diametri i jashtem 2.5-2.55mm, me guide ëire te paravendosur, kanali i punes 2.8mm, teli preres te jete pjeserisht i veshur, me maje atraumatike, me 3 lumen gjatesia e majes 2-2.2mm, gjatesia e telit preres 29-31mm | Cope | 5 |
| 14 | Papapilotom, gjatesia e punes 2000-2010mm, diametri i jashtem 2.5-2.55mm, me guide ëire te paravendosur, kanali i punes 2.8mm, teli preres te jete pjeserisht i veshur, me maje atraumatike, me 3 lumen gjatesia e majes 5-5.3mm, gjatesia e telit preres 20-22mm | Cope | 5 |
| 15 | Papapilotom, gjatesia e punes 2000-2010mm, diametri i jashtem 2.5-2.55mm, me guide ëire te paravendosur, kanali i punes 2.8mm, teli preres te jete pjeserisht i veshur, me maje atraumatike, me 3 lumen gjatesia e majes 5-5.3mm, gjatesia e telit preres 24-26mm | Cope | 10 |
| 16 | Papapilotom, gjatesia e punes 2000-2010mm, diametri i jashtem 2.5-2.55mm, me guide ëire te paravendosur, kanali i punes 2.8mm, teli preres te jete pjeserisht i veshur, me maje atraumatike, me 3 lumen gjatesia e majes 5-5.3mm, gjatesia e telit preres 29-31mm | Cope | 5 |
| 17* | Papapilotom, gjatesia e punes 2000-2010mm, diametri i jashtem 2.5-2.55mm, me guide ëire te paravendosur, kanali i punes 2.8mm, teli preres te jete pjeserisht i veshur, me maje atraumatike me 3 lumen, me age thike, gjatesia e ages 5-5.5mm | Cope | 10 |
| 18 | Papapilotom, gjatesia e punes 2000-2010mm, diametri i jashtem 2.5-2.55mm, me guide ëire te paravendosur, kanali i punes 2.8mm, teli preres te jete pjeserisht i veshur, me maje atraumatike me 3 lumen, me age thike, gjatesia e ages 7-7.5mm | Cope | 5 |
| 19 | Stente biliare, material PE, 2 carje ne 2 fundet per siguruar fiksimin me migrim minimal, vizible nga rrezet X, me 2 vrima anesore, diametri i jashtem 7-7.5Fr, me gjatesi 5cm; 7cm ;10cm, me forme pigtail ne te dy anet | Cope | 5 |
| 20 | Stente biliare, material PE, 2 carje ne 2 fundet per siguruar fiksimin me migrim minimal, vizible nga rrezet X, me 2 vrima anesore, diametri i jashtem 7-7.5Fr, me gjatesi 5cm; 7cm ;10cm, e harkuar 15° | Cope | 10 |
| 21* | Stente biliare, material PE, 2 carje ne 2 fundet per siguruar fiksimin me migrim minimal, vizible nga rrezet X, me 2 vrima anesore, diametri i jashtem 8-8.5Fr, me gjatesi 5cm; 7cm ;10cm, e harkuar 15° | Cope | 10 |
| 22 | Stente biliare, material PE, 2 carje ne 2 fundet per siguruar fiksimin me migrim minimal, vizible nga rrezet X, me 2 vrima anesoreDiametri i jashtem 10-10.5Fr, me gjatesi 5cm; 7cm ;10cm, e harkuar 15° | Cope | 10 |
| 23 | Stenta biliare, material PE, 2 carje ne 2 fundet per siguruar fiksimin me migrim minimal, vizible nga rrezet X, me 2 vrima anesore, diametri i jashtem 7-7.5Fr, me gjatesi 5cm; 7cm ;10cm, me perkulje laterale 45° | Cope | 5 |
| 24 | Stenta biliare, material PE, 2 carje ne 2 fundet per siguruar fiksimin me migrim minimal, vizible nga rrezet X, me 2 vrima anesore, diametri i jashtem 8-8.5Fr, me gjatesi 5cm; 7cm ;10cm,me perkulje laterale 45° | Cope | 5 |
| 25 | Stenta biliare, material PE, 2 carje ne 2 fundet per siguruar fiksimin me migrim minimal, vizible nga rrezet X, me 2 vrima anesore, diametri i jashtem 10-10.5Fr, me gjatesi 5cm; 7cm ;10cm, me perkulje laterale 45° | Cope | 5 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 26 | Introducer , diameter 7-7.5Fr, gjatesia 220-225cm, gjatesia e kateterit te gides 40-42cm | Cope | 20 |
| 27* | Introducer , diameter 8-8.5Fr, gjatesia 220-225cm, gjatesia e kateterit te gides 40-42cm | Cope | 15 |
| 28 | Introducer , diameter 10-10.5Fr, gjatesia 220-225cm, gjatesia e kateterit te gides 40-42cm | Cope | 15 |
| 29 | Stente Biliare / Pankreatike e biodegradueshme ne 12-13 dite , gjatesia 80-82mm, diametri 6 Fr | Cope | 2 |
| 30 | Stente Biliare / Pankreatike e biodegradueshmene 12-13 dite , gjatesia 80-82mm, diametri 8 Fr | Cope | 2 |
| 31 | Stente Biliare / Pankreatike e biodegradueshme ne 12-13 dite , gjatesia 80-82mm, diametri 10 Fr | Cope | 2 |
| 32 | Stente Biliare / Pankreatike e biodegradueshme ne 19-21dite , gjatesia 80-82mm, diametri 6 Fr | Cope | 2 |
| 33 | Stente Biliare / Pankreatike e biodegradueshme ne 19-21dite , gjatesia 80-82mm, diametri 8 Fr | Cope | 2 |
| 34 | Stente Biliare / Pankreatike e biodegradueshmene 19-21dite , gjatesia 80-82mm, diametri 10 Fr | Cope | 2 |
| 35 | Stente Biliare / Pankreatike e biodegradueshme ne 11-12jave, gjatesia 80-82mm, diametri 6 Fr | Cope | 2 |
| 36 | Stente Biliare / Pankreatike e biodegradueshme ne 11-12jave, gjatesia 80-82mm, diametri 8 Fr | Cope | 2 |
| 37 | Stente Biliare / Pankreatike e biodegradueshme ne 11-12jave, gjatesia 80-82mm, diametri 10 Fr | Cope | 2 |
| 38 | Shporte per thyerje dhe terheqje guresh biliare, maje atraumatike, gjatesia e litarit terheqes 200-205cm, multifilament, me madhesi hapje 1.5-1.6 cm | Cope | 2 |
| 39* | Shporte per thyerje dhe terheqje guresh biliare, maje atraumatike, gjatesia e litarit terheqes 200-205cm, multifilament, me madhesi hapje 2-2.1 cm | Cope | 2 |
| 40 | Shporte per thyerje dhe terheqje guresh biliare, maje atraumatike, gjatesia e litarit terheqes 200-205cm, multifilament, me madhesi hapje 3-3.1 cm | Cope | 2 |
| 41 | Shporte per thyerje dhe terheqje guresh biliare, maje atraumatike, gjatesia e litarit terheqes 200-205cm, multifilament, me madhesi hapje 3.5-3.6 cm | Cope | 2 |
| 42 | Rrjeta per terheqje guresh, rrotullim 360°, madhesia e rrjetes 22-23 mm; kateteri 2.5-2.6mm; gjatesia 230-233cm; kanali punes 2.8mm | Cope | 3 |
| 43 | Rrjeta per terheqje guresh, rrotullim 360°, madhesia e rrjetes 26-28 mm; kateteri 2.5-2.6mm; gjatesia 230-233cm; kanali punes 2.8mm | Cope | 3 |
| 44* | Rrjeta per terheqje guresh, rrotullim 360°, madhesia e rrjetes 31-33 mm; kateteri 2.5-2.6mm; gjatesia 230-233cm; kanali punes 2.8mm | Cope | 3 |
| 45 | Rrjeta per terheqje guresh, rrotullim 360°, madhesia e rrjetes 15-16 mm; kateteri 1.6-1.8mm; gjatesia 120-123cm; kanali punes 2.0mm | Cope | 3 |
| 46 | Rrjeta per terheqje guresh, rrotullim 360°, madhesia e rrjetes 15-16 mm; kateteri 1.6-1.8mm; gjatesia 160-163cm; kanali punes 2.0mm | Cope | 3 |
| 47 | Ballona Ekstraktimi Biliare, me 3 lumen, me maje konike atraumatike, gjatesia e punes 2000-2010mm, te jete e dukshme ne rreze X, balona te fryhet me 3 shkalle, diametri i fryrjes te pakten 9-15mm, injektimi i kontrastit pas ballonit (distale) | Cope | 15 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 48* | Ballona Ekstraktimi Biliare, me 3 lumen, me maje konike atraumatike, gjatesia e punes 2000-2010mm, te jete e dukshme ne rreze X, balona te fryhet me 3 shkalle, diametri i fryrjes te pakten 12-18mm, injektimi i kontrastit pas ballonit (distale) | Cope | 15 |
| 49 | Ballona Ekstraktimi Biliare, me 3 lumen, me maje konike atraumatike, gjatesia e punes 2000-2010mm, te jete e dukshme ne rreze X, balona te fryhet me 3 shkalle, diametri i fryrjes te pakten 15-21mm, injektimi i kontrastit pas ballonit (distale) | Cope | 15 |
| 50 | Ballona Ekstraktimi Biliare, me 3 lumen, me maje konike atraumatike, gjatesia e punes 2000-2010mm, te jete e dukshme ne rreze X, balona te fryhet me 3 shkalle, diametri i fryrjes te pakten 9-15mm, injektimi i kontrastit para ballonit (proksimale) | Cope | 5 |
| 51* | Ballona Ekstraktimi Biliare, me 3 lumen, me maje konike atraumatike, gjatesia e punes 2000-2010mm, te jete e dukshme ne rreze X, balona te fryhet me 3 shkalle, diametri i fryrjes te pakten 12-18mm, injektimi i kontrastit para ballonit (proksimale) | Cope | 5 |
| 52 | Ballona Ekstraktimi Biliare, me 3 lumen, me maje konike atraumatike, gjatesia e punes 2000-2010mm, te jete e dukshme ne rreze X, balona te fryhet me 3 shkalle, diametri i fryrjes te pakten 15-21mm, injektimi i kontrastit para ballonit (proksimale) | Cope | 5 |
| 53 | Ballona dilatacioni, me maje konike, me dilacion konstant ne te gjithe gjatesine, me 2 shenime te dukshme nga rrezet X ne 2 krahet e kunderta, kanali i punes 2.8mm, gjatesia e kateterit 1800-1810mm, balloni me diameter 8-9mm dhe gjatesi 55-57mm | Cope | 5 |
| 54 | Ballona dilatacioni, me maje konike, me dilacion konstant ne te gjithe gjatesine, me 2 shenime te dukshme nga rrezet X ne 2 krahet e kunderta, kanali i punes 2.8mm, gjatesia e kateterit 1800-1810mm, balloni me diameter 10-11mm dhe gjatesi 55-57mm | Cope | 5 |
| 55 | Ballon dilatacioni me multi stage, 3 diametra me 3 nivele te ndara presioni, me 2 shenime te dukshme nga rrezet X ne 2 krahet e kunderta, me maje konike atraumatike, me tel te ngurtesuar e paravendosur, me maje hidrofilike radiopak, kanali i punes 2.8mm, gjatesia e kateterit 1800-1810mm, me tre nivele fryrjeje te pakten 6-8mmm, gjatesia balonit 55-57mm | Cope | 2 |
| 56 | Ballon dilatacioni me multi stage, 3 diametra me 3 nivele te ndara presioni, me 2 shenime te dukshme nga rrezet X ne 2 krahet e kunderta, me maje konike atraumatike, me tel te ngurtesuar e paravendosur, me maje hidrofilike radiopak, kanali i punes 2.8mm, gjatesia e kateterit 1800-1810mm, me tre nivele fryrjeje te pakten 8-10mm, gjatesia balonit 55-57mm | Cope | 2 |
| 57 | Ballon dilatacioni me multi stage, 3 diametra me 3 nivele te ndara presioni, me 2 shenime te dukshme nga rrezet X ne 2 krahet e kunderta, me maje konike atraumatike, me tel te ngurtesuar e paravendosur, me maje hidrofilike radiopak, kanali i punes 2.8mm, gjatesia e kateterit 1800-1810mm, me tre nivele fryrjeje te pakten 10-12mm, gjatesia balonit 55-57mm | Cope | 2 |
| 58* | Ballon dilatacioni me multi stage, 3 diametra me 3 nivele te ndara presioni, me 2 shenime te dukshme nga rrezet X ne 2 krahet e kunderta, me maje konike atraumatike, me tel te ngurtesuar e paravendosur, me maje hidrofilike radiopak, kanali i punes 2.8mm, gjatesia e kateterit 1800-1810mm, me tre nivele fryrjeje te pakten 12-15mm, gjatesia balonit 55-57mm | Cope | 2 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 59 | Ballon dilatacioni me multi stage, 3 diametra me 3 nivele te ndara presioni, me 2 shenime te dukshme nga rrezet X ne 2 krahet e kunderta, me maje konike atraumatike, me tel te ngurtesuar e paravendosur, me maje hidrofilike radiopak, kanali i punes 2.8mm, gjatesia e kateterit 1800-1810mm, me tre nivele fryrjeje te pakten 15-18mm, gjatesia balonit 55-57mm | Cope | 2 |
| 60 | Ballon dilatacioni me multi stage, 3 diametra me 3 nivele te ndara presioni, me 2 shenime te dukshme nga rrezet X ne 2 krahet e kunderta, me maje konike atraumatike, me tel te ngurtesuar e paravendosur, me maje hidrofilike radiopak, kanali i punes 2.8mm, gjatesia e kateterit 1800-1810mm, me tre nivele fryrjeje te pakten 18-20mm, gjatesia balonit 55-57mm | Cope | 2 |
| 61* | Pistolete fryrese, per fryrjen dhe shfryrjen e ballonave te dilatacionit dhe balonit multi-stage, me mekanizem quick-lock per shfryrje te shpejte, me mates te presionit. | Cope | 3 |
| 62 | Klipe hemostatike gastrointestinale, me rrotullim 360°, pa limit hapjesh e mbyllje, diametri i klipit 2.6mm, kendi i hapjes 135°, me gjatesi pune 195-200 cm;hapja e nofullave 8-8,5mm | Cope | 15 |
| 63 | Klipe hemostatike gastrointestinale, me rrotullim 360°, pa limit hapjesh e mbyllje, diametri i klipit 2.6mm, kendi i hapjes 135°, me gjatesi pune 230-235 cm; hapja e nofullave 8-8,5mm | Cope | 10 |
| 64* | Klipe hemostatike gastrointestinale, me rrotullim 360°, pa limit hapjesh e mbyllje, diametri i klipit 2.6mm, kendi i hapjes 135°, me gjatesi pune 195-200 cm; hapja e nofullave 11-12mm | Cope | 15 |
| 65 | Klipe hemostatike gastrointestinale, me rrotullim 360°, pa limit hapjesh e mbyllje, diametri i klipit 2.6mm, kendi i hapjes 135°, me gjatesi pune 230-235 cm; hapja e nofullave 11-12mm | Cope | 10 |
| 66 | Klipe hemostatike gastrointestinale, me rrotullim 360°, pa limit hapjesh e mbyllje, diametri i klipit 2.6mm, kendi i hapjes 135°, me gjatesi pune 195-200 cm; hapja e nofullave 16-17mm | Cope | 5 |
| 67 | Klipe hemostatike gastrointestinale, me rrotullim 360°, pa limit hapjesh e mbyllje, diametri i klipit 2.6mm, kendi i hapjes 135°, me gjatesi pune230-235 cm; hapja e nofullave 16-17mm | Cope | 10 |
| 68 | Ligature varicesh ezofagal, kanali i punes 2.8mm, te jete me 6 ligatura, material pa latex, gjatesia 1450mm, diametri i endoskopit 9.4-13mm | Cope | 5 |
| 69* | Ligature varicesh ezofagal, kanali i punes 2.8mm, te jete me 6 ligatura, material pa latex, gjatesia 1900mm, diametri i endoskopit 11-14mm | Cope | 5 |
| 70* | Age skleroterapie, Sheath me diameter 2.3mm, age 22G dhe zgjatim te ages deri ne 4 mm gjatesi 180-185cm | Cope | 220 |
| 71 | Age skleroterapie , sheath me diameter 2.3mm, age 25G dhe zgjatim te ages deri ne 4 mm gjatesi 180-185cm | Cope | 20 |
| 72 | Age skleroterapie , sheath me diameter 2.3mm, age 22G dhe zgjatim te ages deri ne 4 mm gjatesi 200-205cm | Cope | 10 |
| 73 | Age skleroterapie , sheath me diameter 2.3mm, age 25G dhe zgjatim te ages deri ne 4 mm gjatesi 200-205cm | Cope | 10 |
| 74 | Age skleroterapie , sheath me diameter 2.3mm, age 22G dhe zgjatim te ages deri ne 4 mm gjatesi 230-235cm | Cope | 10 |
| 75* | Age skleroterapie , sheath me diameter 2.3mm, age 25G dhe zgjatim te ages deri ne 4 mm gjatesi 230-235cm | Cope | 50 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 76 | Age skleroterapie , sheath me diameter 2.3mm, age 22G dhe zgjatim te ages deri ne 6 mm gjatesi 180-185cm | Cope | 10 |
| 77 | Age skleroterapie , sheath me diameter 2.3mm, age 25G dhe zgjatim te ages deri ne 6 mm gjatesi 230-235cm | Cope | 10 |
| 78* | Age aspirative EUS 22G, sheath 1.8-1.9mm, gjatesia maksimale e ages 80mm, kanali punes 2.8mm, gjatesia e punes: 1375-1415mm | Cope | 70 |
| 79* | Age biopsie EUS 22G, sheath 1.8-1.9, gjatesia maksimale e ages 80mm kanali punes 2.8mm gjatesia e punes 1375mm- 1415mm | Cope | 50 |
| 80* | Forceps biopsie, kanali i punes 2.3mm, gjatesia 180-185cm, me veshje nofulla standarte/ ovale | Cope | 30 |
| 81* | Forceps biopsie, kanali i punes 2.3mm, gjatesia 180-185cm, me veshje nofulla standarte/ ovale me spike | Cope | 40 |
| 82* | Forceps biopsie, kanali i punes 2.3mm, gjatesia 230-235cm, me veshje nofulla standarte/ ovale | Cope | 30 |
| 83* | Forceps biopsie, kanali i punes 2.3mm, jatesia 230-235cm, me veshje nofulla standarte/ ovale me spike | Cope | 30 |
| 84 | Kit PEG gastrostomie 20-24Fr, pull | Cope | 10 |
| 85* | Ngjites per varicet ezofageale dhe fundale, me perberje monomeric n-butyl-2-cyanoacrylate, paketim 0.5ml | Cope | 10 |
| 86 | Stent Esofageal, material Nitinoli, me vete hapje, me veshje te pjesshme, me valvul antirefluks, diametri qendror 20mm diametri fundor 26mm gjatesia 100-105mm | Cope | 2 |
| 87 | Stent Esofageal, material Nitinoli, me vete hapje, me veshje te pjesshme, me valvul antirefluks, diametri qendror 20mm diametri fundor 26mm gjatesia 120-125mm | Cope | 2 |
| 88 | Stent Esofageal, material Nitinoli, me vete hapje, me veshje te pjesshme, me valvul antirefluks, diametri qendror 24mm diametri fundor 26mm gjatesia 100-105mm | Cope | 2 |
| 89 | Stent Esofageal, material Nitinoli, me vete hapje, me veshje te pjesshme, me valvul antirefluks, diametri qendror 24mm diametri fundor 26mm gjatesia 120-125mm | Cope | 2 |
| 90 | Stent biliar me vetehapje, material Nitinoli me funde atraumatike, radiopak, introducer te paravendosur, te vendoset nepermjet endosopit i paveshur , diametri i trupit 10mm, gjatesia 40mm dhe 60mm, gjatesia e introducer 1800mm, | Cope | 2 |
| 91 | Stent biliar me vetehapje, material Nitinoli me funde atraumatike, radiopak, introducer te paravendosur, te vendoset nepermjet endosopit, gjysem i veshur, diametri i trupit 10mm, gjatesia 60mm, gjatesia e introducer 1800mm, | Cope | 2 |
| 92 | Stent biliar me vetehapje, material Nitinoli me funde atraumatike, radiopak, introducer te paravendosur, te vendoset nepermjet endosopit i veshur , diametri i trupit 10mm, gjatesia 40mm dhe 60mm, gjatesia e introducer 1800mm, | Cope | 2 |
| 93 | Boje markuese gastrointestinale me shiringe jo me te vogel se 5ml | Cope | 10 |

III.3.2. Në nenin 46, pika 1 gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia*

*teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;".*

III.3.3. Në nenin 23, pikat 1, 2 dhe 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet se : "1. *Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara. 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. 3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar: a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve; b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

III.3.4. Në nenin 27, pika 1 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, parashikohet se "*Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPPdhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara".*

III.3.5. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. KPP thekson se, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit (*parashikuar nga neni 2 gërma "b" dhe "c" e LPP-së*), janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit

publik. Specifikimet teknike duhet të ofrojnë akses të barabartë për ofertuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustifikuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtarë apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vemendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, parashikuar edhe nga neni 27, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*", i ndryshuar. Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 23 të LPP-së, KPP gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar tre metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me referimin e standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve. Metoda e dytë e hartimit të specifikimeve teknike lidhet me referimin e kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale. Gjithashtu, edhe metoda e tretë, e cila është një ndërthurje e dy metodave të mësipërme, por çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "*ose ekuivalenti i tij/saj*". Autoritet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë me përpikmëri dispozitën e mësipërme të LPP-së në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 "Për prokurimin public" KE, parashikohet se: *"Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat që kërkohet për një punë, shërbim ose furnizim"* Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: "specifikim teknik" nënkupton njërën nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e

tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Cëshjta C-368/10 *"Komisioni Europian vs. Mberëtëria e Hollandës" inter allia* dhe *mutatis mutandis* është arsyetuar se: *"Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen në tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe, kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, oferutesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese."*

Gjithashtu, nga ana tjetër Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë që në respekt të nenit 63 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *"Për prokurimin publik"* të ndryshuar ku parashikohet se: *"Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin."* Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendojsen në pah të *ratio legis*, mbështetur edhe në parimin e e së drejtës se *ratio legis est anima legis*, (*qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit*), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. KPP thekson se, pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik në lidhje me specifikimet teknike se disa nga produktet të drejtojnë drejtë një prodhuesi të vetëm por pa përcaktuar se cilat specifikime teknike apo parametra të përcaktuara për produktet nga ana e autoritetit kontraktor kufizojnë pjesmarrjen e operatorëve ekonomik, nuk përbën një kusht *sine qua non* se specifikimet teknike janë hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik. Pra, operatorët ekonomikë duhet të argumentojnë/dëshmojnë se specifikimet teknike parametrat e produkteve të hartuara nga autoriteti kontraktor janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik dhe jo mbi faktin se këto të fundit nuk plotësohen nga një ose disa prodhues kombëtar/ndërkombëtar me reputacion. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e autoritetit kontraktor dhe të hartojë e argumentojë të gjitha kriteret e procedurës së prokurimit në themel. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për hartimin jo të saktë të kritereve kualifikuese, specifikimeve teknike apo parametrave të produkteve. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për hartimin e kritereve të mësipërme në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit public. ndërkohë që KPP adapton një pozicion re-aktiv, në pritje të argumenteve të plotë provues se cilat kritere/specifikime teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë të gabuara apo diskriminuese.

Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicje të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementëve përbërës të dokumentave të tenderit, specifikimet teknike, sikundër në

rastin konkret, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP. Komisioni i Prokurimit Publik është paraparë nga ligji si një quasi gjykatë. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument.

Rrjedhimisht pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, nuk merren në shqyrtim

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "*Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *"Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19",* Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë.

**Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "*Montal*" sh.p.k. për procedurën e prokurimit "*Procedurë e Hapur",* me Nr. *REF- 83794-01-11-2021*, me objekt "*Sigurimin e ageve të skleroterapisë për trajtimin e pacientëve me hemoragji digjestive dhe ageve të biopsisë për diagnozën e pacientëve me patologji të traktit tretës, si dhe materiale mjekësore për endoskopi për vitin 2020-2021",* me fond limit *18,796,810* lekë pa tvsh dhe shumatorja e çmimeve për njësi: *4,301,650.00* leke pa tvsh, publikuar më datë 12.01.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e tjerë të procedurës së mësipërme të prokurimit.

3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 155 Protokolli, Datë 28.01.2021**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

| **Nënkryetar** | **Anëtar** | **Anëtar** | **Anëtar** |
|---|---|---|---|
| **Enkeleda Bega** | **Vilma Zhupaj** | **Lindita Skeja** | **Merita Zeqaj** |

**Kryetar**
**Jonaid Myzyri**

Jonaid Myzyri
Digitally signed by Jonaid Myzyri
Date: 2021.02.22 12:18:08 +02'00'